

THE KOSOVO BANKER

Sektori bankar si kontribues primar i financimit të qëndrueshëm në Kosovë

Financimi i qëndrueshëm për një Kosovë më të gjelbër

Si bëhet menaxhimi mjedisor dhe social nga një bankë e përgjegjshme?

Financimi i Qëndrueshëm



20 VITE
—
BESIM DHE
PARTNERITET



**Banka
Ekonomike**



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION



THE KOSOVO BANKER

IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



ALBERT LUMEZI
NLB Bank / Kryetar i Bordit të SHBK



SUAT BAKKAL
Banka Kombëtare Tregtare /
Zv. Kryetar i Bordit të SHBK



PETRIT BALIJA
Shoqata e Bankave të Kosovës



ANITA KOVACIC
Raiffeisen Bank



ARTION CELINA
Banka për Biznes



ERIOLA BIBOLLI
ProCredit Bank Kosova



MERITON SUNDURI
Ziraat Bank



OGUZHAN CEYLAN
IS Bank



ORCUN OZDEMIR
TEB Bank



SELMAN LAMA
Credins Bank



SHPEND LUZHA
Banka Ekonomike

KRYEREDAKTOR:
Petrit Balija

ASISTENTE PUBLIKIMI:
Anesa Besimi



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) është zëri i industrisë bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Mediat me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

The Kosovo Banker është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës, 177, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

PËRMBAJTJA

EDITORIAL

- 06 **PETRIT BALIJA** - Kryeshef Ekzekutiv -
Shoqata e Bankave të Kosovës

PARATHËNIE

- 07 **ALBERT LUMEZI**, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës / Kryetar i Bordit Udhëheqës, NLB Banka, **Sektori bankar si kontribues primar i financimit të qëndrueshëm në Kosovë**

10 KËNDI I INTERVISTËS

ANITA KOVACIC - Drejtore ekzekutive, Raiffeisen Bank në Kosovë, **Financimi i qëndrueshëm për një Kosovë më të gjelbër - Standardet Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes**

12 KËNDI I INSTITUCIONEVE

DONIKA BAJRAMI DEVAJA
Zv/Zyrtare për Pajtueshmëri për Parandalimin e Pastrimit të Parave, FINCA Kosovë, **Përfshirja financiare dhe PPP/LFT në Institucionet Mikrofinanciare**

- 14 **20 vite Besim dhe Partneritet**
SHPEND LUZHA - Kryeshef Ekzekutiv,
Banka Ekonomike

- 15 **20 vjet bankë e vendit, BPB feston dy dekada jetë**
ARTON CELINA - Kryeshef Ekzekutiv,
Banka për Biznes

- 16 **Revolucioni i Qëndrueshmërisë për Biznesin,**
WAYNE ELSEY - Themelues dhe Kryetrajner/Kryeshef
Ekzekutiv, The Funds2Orgs Group



20 SEKTORI FINANCIAR

ARMOND RANQOLLI, Chief Risk Officer,
Banka Ekonomike, **Adresimi i risqeve përmes mundësisë së rritjes së financimit të qëndrueshëm**

- 24 **JETON SHATRI**
Kordinator për Risk & Koordinator
për ESG, NLB Banka Prishtina, &
MIRSAD HASKAJ, Zyrtar Kryesor për Risk & Zyrtar për
ESMS, NLB Banka Prishtina,
Pruga drejt financimit të qëndrueshëm



- 26 **FATMIRE IMERAJ**
Specialiste për Financim të Qëndrueshëm, Raiffeisen
Bank Kosovo, **Financim i Qëndrueshëm | Ndikimi në
ekonomi dhe shoqëri**

- 29 **ARBËRIE PACOLLI**
Kordinatore e Hipotekës dhe Lizingut të Pasurive të
Paluajtshme, Banka Ekonomike, **Industria bankare dhe
roli i saj drejt financimit të qëndrueshëm**

- 30 **FATOS HASANI**
Udhëheqës i njësisë për menaxhimin mjedisor, Banka
ProCredit Kosovë, **Tranzicioni energjetik dhe investimet
në burime të energjisë diellore në Kosovë**

- 32 **GENTIANA HALIMI**
Specialiste e Lartë e Departamentit të
Institucioneve Financiare,
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë,
**Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm drejt financimit
të qëndrueshëm**

KËNDI I EKSPERTËVE

- 33 **VISAR PAÇARADA**
Anëtar i bordit menaxhues,
ProCredit Bank Kosova, **Si bëhet menaxhimi mjedisor
dhe social nga një bankë e përgjegjshme?**

35 BANKAT FUQIZOJNË SHOQËRINË



**Raiffeisen
BANK**



**Grupi i parë bankar austriak
nënshkrues i parimeve të KB
për operim të përgjegjshëm.**



EDITORIAL



PETRIT BALIJA

KRYESHEF EKZEKUTIV - SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

Financimi i qëndrueshëm synon integrimin e kriterëve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes së mirë (ESG) në shërbimet financiare dhe në mbështetjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Sektori bankar, si një nga shtyllat më të rëndësishme të stabilitetit financiar të Kosovës, është duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe transparencës së akterëve financiarë, ndërmarrjeve të biznesit dhe autoriteteve shtetërore për nevojën për të implementuar kriteret e nevojshme për një Kosovë më të gjelbër dhe një ekonomi më të qëndrueshme. Ky edicion i “The Kosovo Banker” vendos një theks të veçantë kësaj axhende globale me implikime edhe në Kosovë.

Përveç kontributit primar në rimëkëmbjen ekonomike, sektori bankar po vazhdon të jap një kontribut të çmuar në mbështetje të shoqërisë përmes donacioneve dhe aktiviteteve të shumta të vullnetarizmit dhe përgjegjësisë sociale. Kjo na frymëzon që të vazhdojmë punën tonë për të tejkaluar të gjitha sfidat dhe për të ndërmarrë hapa të guximshëm drejt një të ardhme më të mirë për ekonominë e vendit tonë.

Në këtë edicion të “The Kosovo Banker” ju ftojmë të ndiqni pikëpamjet më të reja rreth temës “Financimi

i Qëndrueshëm - Standardet Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse për Financim të Qëndrueshëm në Kosovë”. Kjo temë ka qenë diskutimi kryesor edhe në Konventën Vjetore të Bankave për vitin 2021, ku sektori bankar dhe akterë relevant janë zotuar për një vëmendje të shtuar për këtë axhendë të rëndësishme. Ky edicion zgjerohet në këtë diskutim duke mundësuar kontribute të ndryshme të autorëve për të nxitur diskutim dhe debat në këtë fushë me qëllim që të avancohet në këtë drejtim në vitin 2022.

Gjithashtu, dëshiroj të ju njoftoj që Shoqata e Bankave të Kosovës ka vendosur që kjo revistë “The Kosovo Banker”, që nga ky edicion, do të publikohet vetëm në formë elektronike, kështu duke u përshtatur me kërkesat e anëtarëve tanë të cilët përmes anketimit në shumicë dërmuese kanë shprehur propozimin që publikimi të mundësohet vetëm

përmes kanaleve elektronike. Është koincidence e bukur që vendimi për të mos printuar më tutje kopje fizike të këtij publikimi vjen pikërisht në edicionin i cili për temë kryesore ka trajtimin e kriterëve ambientale dhe shoqërore.

Jemi falënderues për të gjithë autorët dhe sponsorët që na mbështetën në realizimin e këtij edicioni.



**ALBERT LUMEZI**

Kryetar i Bordit të Drejtorëve, Shoqata e Bankave të Kosovës /
Kryetar i Bordit Udhëheqës, NLB Banka

Sektori bankar si kontribues primar i financimit të qëndrueshëm në Kosovë

Gjatë dy dekadave të fundit, sektori bankar ka arritur të ndërtojë institucione solide bankare të cilat kanë ruajtur stabilitetin dhe krahas zhvillimeve bashkëkohore ka avancuar shërbimet financiare. Sektori bankar ka arritur që të kreditojë ekonominë e Kosovës me mbi 1.5 miliard euro gjatë vitit 2021, duke shënuar kështu një rritje dyshifrore të kreditimit. Pjesa më e madhe e këtij kreditimi është të alokuar për ndërmarrje afariste me rreth 62% pjesëmarrje në portofolin kreditor.

Sektorët të cilët kanë shënuar rritje më të theksuar në kreditim janë sektori i prodhimit, sektori i ndërtimitarisë dhe sektori i shërbimeve. Kjo është mjaft inkurajuese sepse është një indikator i rëndësishëm që struktura e ekonomisë së vendit është duke ndryshuar, ku pjesëmarrja e tregtisë në kreditim tanimë është vetëm 45% për dallim nga vitet paraprake ku ishte në mbi 50%, kështu duke u balancuar me sektorët tjerë të rëndësishëm si prodhimi dhe shërbimet.

Depozitat janë rritur ndjeshëm po ashtu me një rritje prej mbi 15%, duke arritur në mbi 4.6 miliardë euro. Ekonomitë familjare janë depozituesit kryesorë dhe marrin pjesë me

DEPOZITAT JANË RRRITUR
NDJESHËM PO ASHTU ME
NJË RRRITJE PREJ MBI

15%

DUKE ARRITUR NË MBI

4.6

MILIARDË EURO

EKONOMITË FAMILJARE
JANË DEPOZITUESIT
KRYESORË DHE MARRIN
PJESË ME 68.5% NË
GJITHSEJ DEPOZITAT NË
SEKTORIN BANKAR.

68.5% në gjithsej depozitat në sektorin bankar. Kjo rritje e depozitave ka bërë që raporti i kredive ndaj depozitave të mbetet në nivele të ngjashme me tre vitet e kaluara në rreth 75%, gjë që tregon për një likuiditet të lartë në sektorin bankar.

Kreditë joperformuese mbeten në nivelin më të ulët me vetëm 2.4% pjesëmarrje në gjithsej kreditë. Menaxhimi i mirë i performancës së kredive vazhdon të mbetet prioritet i sektorit bankar për të siguruar stabilitet dhe qëndrueshmëri të sektorit. Përkundër lehtësimeve që sektori bankar ka ofruar gjatë pandemisë për bizneset dhe ekonomitë familjare, kemi arritur që të menaxhojmë këto situata dhe bashkërisht me klientët tanë të tejkalojmë vështirësitë financiare pa dëmtuar performancën e kredive.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i bankngut është edhe shërbimi i pagesave dhe dixhitalizimi i shërbimeve. Si sektor bankar kemi investuar dhe vazhdojmë të investojmë mjaft shumë në dixhitalizim të shërbimeve në mënyrë që të lehtësojmë qasjen e qytetarëve në shërbime bankare dhe të jemi prezent në të gjitha pjesët e vendit me shërbimet tona përmes internetit dhe pajisjeve elektronike.



Vështirësitë e shkaktuara nga pandemia kanë bërë që të kuptojmë se bota nuk mund të rrijë duarkryq karshi kërcënimeve të mëdha globale që cenojnë njerëzimin, si ndryshimet klimatike por edhe problemet që mund të shkaktohen nga padrejtësitë sociale dhe të keq qeverisjes.

Megjithatë, për të plotësuar këtë shërbim, Kosova duhet të miratojë edhe aktet nën-ligjore të cilat parashihen me Ligjin për Identifikimin Elektronik i cili do të mundësojë që qytetarët të kryejnë shërbimet bankare krejtësisht online dhe në mënyrë dixhitale, pa humbur kohë në sportelet e bankave. Kjo do të ulte edhe koston si për institucionet bankare, ashtu edhe për klientët dhe do të bënte sektorin bankar më konkurrent në ofrimin e shërbimeve inovative financiare.

Vështirësitë e shkaktuara nga pandemia kanë bërë që të kuptojmë se bota nuk mund të rrijë duarkryq karshi kërcënimeve të mëdha globale që cenojnë njerëzimin, si ndryshimet klimatike por edhe problemet që mund të shkaktohen nga padrejtësitë sociale dhe të keq qeverisjes. Marrja e masave në uljen e ndotjes mjedisore përballë ndryshimeve aktuale klimatike, po ashtu është çështje që kërkon trajtim të veçantë dhe kujdes të shtuar. Prandaj, ruajtja e mjedisit është përgjegjësi e secilit prej nesh, pa marrë parasysh profilin e veprimtarisë sonë, në veçanti për ne si sektor financiar dhe kontribuesit më të mëdhenj në zhvillimin ekonomik. Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike e bazuar në konventën kornizë të Kombeve të Bashkuara ka vënë në lëvizje edhe industrinë financiare që të bëhen pjesë e këtyre iniciativave për një botë më të gjelbër dhe një ekonomi më të qëndrueshme. Edhe bankat në Kosovë, duke qenë pjesë e grupeve të mirënjohura ndërkombëtare

janë pjesë përbërëse të institucioneve që kanë nënshkruar parimet e marrëveshjes së Parisit, prandaj ne besojmë se edhe Kosova mund të përfitojë shumë nga kjo agjendë.

Ne, si sektor bankar jemi të përkushtuar të punojmë së bashku në këtë agjendë, me fokus në:

- **përgjegjësinë sociale**, duke kontribuar drejt zhvillimit më të gjerë socio-ekonomik nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, me përgjegjësi të lartë ndaj klientëve, punonjësve dhe mjedisit social duke kontribuar në vazhdimësi edhe në mbështetjen e aktiviteteve sportive, humanitare dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- **financim të qëndrueshëm e të përgjegjshëm**, duke integruar kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në vendimet tona të të bërit biznes dhe investimeve, me qëllim të përfitimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm për shoqërinë tonë në përgjithësi.

Në këtë mënyrë duke ngritur gradualisht standardet për financim të qëndrueshëm, ne mund të sigurojmë një ambient më të pastër për Kosovën. Po ashtu, ne mund të jemi nxitës të reduktimit të informalitetit që do të rriste mirëqenien sociale dhe ekonomike në vend si dhe qasjen më të lehtë në financa për grupe të marginalizuara. Në fund, por jo më pak e rëndësishme është edhe qeverisja e mirë, pasi që e dimë se sa mund të ndihmojë qeverisja e mirë në sigurimin e investimeve të huaja dhe hapjen e mundësive të reja për bizneset në Kosovë.

Shkarko **NLB PAY** FALAS

GET IT ON
Google Play



A e keni provuar sa i lehtë
është përdorimi i **NLB PAY**?



 **NLB Banka**

**ANITA KOVACIC**

Drejtoreshë ekzekutive, Raiffeisen Bank në Kosovë

Financimi i qëndrueshëm për një Kosovë më të gjelbër - Standardet Mjedisore, Sociale dhe të Qeverisjes

1

A KA RAIFFEISEN BANK NË KOSOVË NJË STRATEGJI TË QËNDRUESHME FINANCI MI PËR KALIM NË KRITERET E ESG-SË?

Strategjia e Raiffeisen Bank në Kosovë ka qenë gjithmonë e bazuar në banking të përgjegjshme dhe rritje të qëndrueshme. Që nga ky vit kur u bëmë nënshkruar zyrtar i Parimeve të OKB-së për Banking të Përgjegjshëm, të cilat në mënyrë specifike përcaktojnë dhe promovojnë standardet e ESG-së, jemi angazhuar në mënyrë aktive për të mbështetur tregun kosovar, dhe në veçanti klientët tanë, në kalimin e flukseve të tyre të kapitalit dhe praktikave afariste sipas kriterëve të ESG-së. Strategjia jonë kalimtare për të integruar standardet e ESG-së është gjithëpërfshirëse, ajo përcakton kriteret për financimin e qëndrueshëm të klientëve tanë, propozimin e produkteve të qëndrueshme, si dhe kalimin në ekologjinë e brendshme më të gjelbër, mirëqenien e punonjësve tanë dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mbështetjen për një sërë aktivitetesh përmes sponsorizimeve dhe donacioneve për të dhënë kontribut pozitiv në shoqërinë kosovare.

Është gjithashtu e rëndësishme të shtohet se tregu kosovar, duke përfshirë klientët tanë, ka ende nevojë për kohë për të përqaftuar këto qasje të qëndrueshme të ESG-së të sapo përcaktuara, prandaj strategjia jonë e ESG-së në Raiffeisen Bank në Kosovë është e një tranzicioni afatgjatë.

2

CILAT JANË DISA MËNYRAT SE SI RAIFFEISEN BANK NË KOSOVË MUND TË KONTRIBUOJË NË AGJENDËN E GJELBËR NË KOSOVË?

Kosova është e përkushtuar ndaj agjendës së gjelbër të udhëhequr nga BE-ja që nga viti 2020, e njohur si Deklarata për Agjendën e Gjelbër në Ballkanin Perëndimor. Ne e kuptojmë se disa nga kriteret mjedisore do të jenë të vështira për t'u zbatuar, megjithatë, BE-ja tashmë është në dijeni të këtyre vështirësive dhe ka dedikuar shuma të mëdha fondesh që do të mbështesin vendet e Ballkanit për të përmbushur këto standarde të reja. Mund të them se ambicia dhe motivimi i Bankës sonë është të jemi të gatshëm që të jemi ndër partnerët e parë të qeverisë që do të mbështesim Kosovën për të bërë hapa konkretë në këtë drejtim. Roli jonë në treg nuk është thjesht të financojmë tranzicionin, por do të ndajmë njohuritë dhe ekspertizën që kemi mësuar tashmë në tregjet e tjera të Grupit Raiffeisen dhe do t'i ofrojmë ato për të mbështetur klientët tanë për të përfituar nga mundësitë e reja që do të krijohen në treg. Ne do t'u ofrojmë klientëve tanë kredi për produkte të gjelbra për të financuar projekte që ofrojnë përfitime të matshme mjedisore, si kalimi në energjitë e ripërtëritshme ose përmirësimi i efikasitetit të energjisë, mbështetje për tranzicion në ekonomi rrethore ose ndonjë kredi tjetër për projekte të gjelbra për të ndihmuar klientët tanë të adresojnë kalimi në reduktimin ose neutralitetin e karbonit.



ESG është një temë relativisht e re edhe në vendet e zhvilluara, prandaj e kuptojmë nevojën që Kosova si vend në zhvillim ka nevojë për më shumë informacione mbi parimet e ESG-së dhe bankungun e përgjegjshëm. Strategjia e komunikimit të Raiffeisen Bank për ESG vitin e ardhshëm do të fokusohet si në informimin e publikut ashtu edhe të klientëve.

3

CILA ËSHTË STRATEGJIA PËR T'UA KOMUNIKUAR KLIENTËVE TUJ DHE PUBLIKUT KËTË INICIATIVË TË RE (PËR PJEKJET E RBKO-SË DUKE PËRFSHIRË EDHE PËR PJEKJET E SHBK-SË PËR VITIN E ARDHSHËM)?

ESG është një temë relativisht e re edhe në vendet e zhvilluara, prandaj e kuptojmë nevojën që Kosova si vend në zhvillim ka nevojë për më shumë informacione mbi parimet e ESG-së dhe bankungun e përgjegjshëm. Strategjia e komunikimit të Raiffeisen Bank për ESG vitin e ardhshëm do të fokusohet si në informimin e publikut ashtu edhe të klientëve. Do të punojmë ngushtë me palë të ndryshme të interesit në Kosovë, duke përfshirë SHBK-në për të përshkruar parimet e ESG-së dhe për të paraqitur informacionin përkatës mbi rolin që bankingu i përgjegjshëm mund të luajë për të mbështetur agjendën e vendit për ESG. Sa i përket klientëve tanë, përveç komunikimit publik, do të kemi edhe takime me ta dhe do të organizojmë tryeza të rrumbullakëta të cilat do të na mundësojnë të diskutojmë tërësisht përgjegjësitë tona, si dhe të koordinojmë dhe harmonizojmë objektivat tona në lidhje me ESG-në për të siguruar që zhvillimi i aktiviteteve tona që kontribuojnë ndjeshëm në objektivat e qëndrueshme.

4

CILAT JANË DISA NGA SFIDAT E PËRSHTATJES SË AGJENDËS PËR FINANCIM TË QËNDRUESHËM NË TREGUN KOSOVAR?

Sfidat janë gjithashtu mundësi. Sfida më e madhe ende është ndërgjegjësimi i ulët dhe si rrjedhojë prioritizimi i ulët i rëndësisë në treg. Shumë nga sfidat aktuale mjedisore dhe sociale në Kosovë mund të zgjidhen në kuptim afatgjatë duke punuar drejt zbatimit të standardeve të ESG-së, siç janë mbështetja e aktiviteteve afariste që janë në përputhje me ligjin mjedisor dhe të punës ose duke kontribuar në investimet në komunitet. Mundësitë për të marrë fonde dhe ekspertizë të mjaftueshme për të zbatuar projekte të tilla mund të duken të pakta, por me motivimin e duhur, bashkëpunimin nga institucionet publike përgjegjëse dhe sektorin privat, së bashku mund zhvillojë në mënyrë proaktive projekte dhe modele biznesi të qëndrueshme për të pasur ndikim pozitiv në brezat aktual dhe të ardhshëm.

Pa diskutim teknologjitë e reja të sjella nga Fintech-et vazhdojnë të sfidojnë status quo-në e industrisë bankare. Bankat mund të ndjekin shembullin dhe të përshtaten me teknologjitë e reja të disponueshme, gjithmonë duke e pasur në qendër klientin.

**DONIKA BAJRAMI DEVAJA**

ZV/ZYRTARE PËR PAJTUESHMËRI PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE, FINCA KOSOVË

Përfshirja financiare dhe **PPP/LFT** në Institucionet Mikrofinanciare

Institucionet mikrofinanciare në Kosovë shfaqen si formë e re e bankingut të cilat ofrojnë vetëm një produkt shumë specifik -“kreditë”, duke mundësuar kështu **qasje në shërbime financiare** (përfshirje financiare) me fokus parësor tek grupi i njerëzve me të ardhura të ulëta, në mënyrë që të kontribuojnë në përmirësimin e standardeve të jetesës së tyre, që është në përputhje me misionin e FINCA Kosovë si pjesë e rrjetit FINCA Impact Finance me seli në Washington, DC.

Krahas kësaj, Institucionet mikrofinanciare kanë qëllimin primar që të angazhohen në qeverisje të mirë korporative, të sigurojnë pajtueshmërinë rregullative dhe të mbrojnë të dhënat e klientëve nga mashtrimet e mundshme duke investuar për një program efektiv të PPP/LFT.

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PËRFSHIRJA FINANCIARE DHE PPP/LFT?

Përfshirja financiare i referohet procesit nëpërmjet të cilit një grup i njerëzve, që për një ose më shumë arsye nuk janë klientë të bankave, u mundësohet qasja në shërbime të përballueshme financia-

re- mikrofinanciare dhe në çdo kohë. Me fjalë të tjera në qoftë se nuk do të ofrohejshin këto mundësi financiare nga institucionet mikrofinanciare, kjo do i shtynte këtë grup të njerëzve të qasen në kanale jo formale dhe kjo do të paraqet vështirësi në identifikimin dhe monitorimin e transaksioneve të dyshimta nga kontrollat e PPP të institucionit, duke bërë kështu programin e PPP/LFT më të mangët. Prandaj, është shumë e rëndësishme të vendoset një balancë midis mekanizmeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe zhvillimit të shërbimeve financiare, me fjalë të tjera, të njohjes së klientit tuaj (KYC) dhe kërkesave të kujdesit të duhur ndaj klientit (CDD) për transaksione, produkte dhe shërbime financiare specifike.

Bazuar në standardet e FATF, çdo vend duhet të performojë vlerësimin e rrezikut duke marrë për bazë rreziqet e PP/FT e veçanërisht për grupet e caktuara të klientëve dhe produktet specifike për të mbështetur përfshirjen financiare. Produktet dhe klientët specifik të cilësuar sipas standardeve të FATF për të mbështetur përfshirjen financiare mund të paraqesin një rrezik më të ulët kur i nënshtrohen kufizimeve, të tilla si në vijim:

- MËNYRA E MARRËDHËNIES SË BIZNESIT OSE KRYERJES SË TRANSAKSIONIT (P.SH KLIENTË BALLË PËR BALLË OSE NGA DISTANCA)
- LLOJI I KLIENTËVE QË PËRFITOJNË SHËRBIMET FINANCIARE (P.SH. VETËM PËR KLIENTËT VENDOR)
- LIMITI I TRANSAKSIONEVE TË REALIZUARA OSE VLERA TOTALE E TRANSAKSIONEVE NË DITË/JAVË (P.SH PAGESA MAKSIMALE E PRANUAR NË PARA NË TË GATSHME 5000 EURO).

Duke u bazuar në kufizimet e cekura më lartë institucionet mikrofinanciare konsiderohen se kanë ekspozim më të ulët të rrezikut nga PP pasi produkti i

ofruar –Kredia, mund të konsiderohet si produkt me rrezik të ulët për qëllimet e PP-së, po ashtu lloji i klientëve konsiderohet me rrezik të ulët pasi fokusi është ofrimi i shërbimeve vetëm për klientë vendor si dhe vlera e parave të gatshme, limitet e pagesave, transaksioneve ditore janë relativisht të ulëta.

PËRPARSITË DHE MANGËSITË E PËRFSHIRJES FINANCIARE DIXHITALE DHE PPP/LFT

Përfshirja financiare dixhitale nënkupton përdorimin e produkteve dhe shërbimeve financiare dixhitale, e cila gjatë viteve të fundit po ndryshon edhe metodologjitë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Nëse e pasqyrojmë në një peisazh global financiar - **teknologjinë financiare**, e cila vazhdimisht ka tendenca në zhvillime e sipër, për këtë institucionet

mikrofinanciare duhet të mendojnë për të adresuar sfidat në aspektin kulturor, teknologjik dhe operacional. Pikërisht këtë po e bën FINCA Kosovë (pjesë e rrjetit të FINCA Impact Finance), e cila ka në konsideratë aplikimin e teknologjive të reja që të përshpejtoj procesin e kredidhënies dhe lehtësoj akoma më shumë qasjen në shërbime për personat e përjashtuar nga sistemi financiar.

Njëkohësisht, përdorimi i teknologjisë së re ndihmon në identifikimin e klientëve në mënyrë më të saktë dhe më efektive duke rritur besueshmërinë, sigurinë duke minimizuar kështu mundësinë e gabimeve njerëzore gjatë procesit KYC.

Mirëpo vlen të theksohet në anën tjetër se përfshirja financiare dixhitale mund të shoqërohet me mangësitë e saj, e që mund të paraqesin një rrezik të lartë për institucionet mbi vjedhjen e identitetit ose duke futur identitete fiktive nga kri-

minelët që kërkojnë të vjedhin të dhëna ose identitete të klientëve. Kjo mund të jetë një mundësi për këto institucione që të vlerësojnë akoma më shumë kontrollet e PPP për të parandaluar, zbuluar dhe menaxhuar rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si rrjedhojë e aplikimit të teknologjisë së re dhe sfidat që mund t'i kenë. Thënë thjesht, përfshirja financiare dhe luftimi i PP/LFT duhet të shikohen si objektiva parësore e politikës kombëtare/shtetërore, duke ndikuar që grupi i personave të përjashtuar nga sistemi financiar të futën në sistem financiar formal nga ai jo formal.

Si përfundim, përfshirja financiare dhe PPP/LFT shoqërojnë njëra me tjetrën, d.m.th., një program efektiv i PPP/LFT mund të promovojë financimin dhe gjithashtu një sistem financiar gjithëpërfshirës mund të rrisë efektivitetin e një kuadri PPP/LFT.



Të ndërtojmë të nesërmën së bashku!



SHPEND LUZHA

KRYESHEF EKZEKUTIV, BANKA EKONOMIKE

20 vite Besim dhe Partneritet

Viti 2021 nuk është vetëm një përvjetor i korporatës sonë, por është dhe një përvjetor i një familje që rrugëtimin e nisi 20 vite më parë, si banka e vetme me kapital 100 % vendor, ashtu siç vazhdojmë të jemi edhe sot.

20 vite më parë, duke parë nevojën për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit, me qëllim të mbështetjes së rindërtimit dhe zhvillimit të vendit, aksionarët tanë investuan edhe në sektorin bankar.

Banka Ekonomike fillimisht filloi të operojë me tri degë, Prishtinë, Gjakovë dhe Pejë, për të vazhduar me zgjerimin e rrjetit të degëve në gjithë vendin, ku sot jemi prezent me mbi 30 degë dhe mbi 350 punëtorë në gjithë territorin e Republikës të Kosovës.

Sot, në 20 vjetorin e Bankës Ekonomike, kam kënaqësinë e veçantë të falënderoj të gjithë klientët e institucionit tonë për besimin dhe partneritetin që ndërtuam gjatë këtyre viteve. Një mirënjohje dhe falënderim i veçantë i dedikohet edhe të gjithë punonjësve që ishin dhe janë pjesë e Bankës, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm bënë që ky institucion të arrij këtu ku jemi sot. Falënderim i veçantë për aksionarët e Bankës, të cilët mbështeten vazhdimisht rritjen dhe zhvillimin e institucionit tonë, si dhe Bankën Qendrore e cila luajti rol kyç në zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit bankar.

Për 20 vite, Banka Ekonomike ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë. Përgjatë dy dekadave të operimit, përmes produkteve kreditore

BANKA EKONOMIKE
FILLIMISHT FILLOI TË
OPEROJË ME TRI DEGË,

**PRISHTINË
GJAKOVË
PEJË**

PËR TË VAZHDUAR ME
ZGJERIMIN E RRJETIT TË
DEGËVE NË GJITHË VENDIN,
KU SOT JEMI PREZENT ME
MBI

**30
DEGË DHE MBI**

**350
PUNËTORË**

NË GJITHË TERRITORIN E
REPUBLIKËS TË KOSOVËS.

kemi financuar nevojat e klientëve tanë me afro 2 miliardë euro, si dhe kemi shërbyer me mijëra klientë me produkte dhe shërbime bankare.

Investimet në resurset njerëzore dhe rritja e vazhdueshme e besimit të klientëve ka rezultuar me arritjen e sukseseve të shumta ndër vite, andaj sot le të shënojmë këtë ditë si një festë për secilin prej nesh!

Përvjetorë si ky, përveç që na bëjnë krenar, në të njëjtën kohë na shtyjnë për angazhim të mëtejshëm drejt të ardhmes. Forcimi i mëtejshëm i pozicionit të Bankës Ekonomike në sektorin bankar është një nga objektivat kryesore. Në këtë drejtim, jemi duke punuar që Bankën Ekonomike ta fuqizojmë me tej në vazhdimësi, duke qenë një nga akterët kyç në tregun financiar. Në këtë drejtim do të vazhdojmë me investime në infrastrukturë teknologjike dhe resurse njerëzore. Partneriteti me klientin është parimi bazë i punës sonë, këtë e dëshmuam edhe në vitin e shkuar kur edhe përkundër rrethanave të krijuara me pandeminë, vazhduam mbështetjen e klientëve përmes financimit të pandërrerë.

Duke qenë Banka e vetme me kapital 100 % vendor, gjatë rrugëtimin tonë 20 vjeçar kemi qenë shumë të përkushtuar edhe në aspektin e përgjegjësisë sociale, e ky rol do të vazhdojë të jetë edhe më aktiv në të ardhmen duke qenë afër kulturës, sportit, shëndetësisë, edukimit, kategorive të marginalizuara dhe iniciativave të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin dhe mirëqenien shoqërore.

Në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv dëshiroj të urojë për zemërsisht të gjithë punonjësit, klientët, aksionarët dhe bashkëpunëtorët tanë – **Gëzuar 20 vjetori i Bankës Ekonomike!**



ARTION CELINA

KRYESHEF EKZEKUTIV, BANKA PËR BIZNES

20 vjet bankë e vendit, BPB feston dy dekada jetë


Viti 2021 ka shënuar 20 vjetorin e punës së Bankës për Biznes. Fillet e BPB-së, dy dekada më parë ishin ndërtaur mbi vizionin e qartë: besimin, guximin e motivin. Këto tri vlera tashmë janë bërë identifikues të bankës së vendit. Themeluesit e BPB-së mund të mos kishin qenë në gjendje ta parashikonin se si do të dukej tregu bankar në Kosovë 20 vite më vonë, por, themelet që kanë krijuar ata bënë që banka e vendit të arrijë të jetë qëndrestare në rrugën e saj, ndërsa, viteve të fundit është rritur dukshëm, duke konsoliduar vendin e saj në sektorin bankar vendor. Rritja e vazhdueshme e bankës ka bërë që BPB-ja të zgjerohet në 26 degë në tërë Kosovën, me mbi 350 punëtorë, por që ky numër po rritet dita ditës, duke iu shërbyer kështu mbi 50 mijë klientëve. Ripozicionimi i Bankës për Biznes, si partner kryesor i bizneseve të vogla dhe të mesme, ka rezultuar në periudhën më të suksesshme të operimit të institucionit tonë. Duke ditur që kjo kategori e bizneseve ka qasje të limituar në financa, e njëkohësisht janë punëdhënësit më të mëdhenj në nivel të vendit, BPB po kontribuon në këtë mënyrë drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së komunitetit.

Modeli jonë i biznesit bazohet në zhvillimin e klientëve në aspektin e shërbimeve financiare dhe jofinanciare. Gjatë këtyre viteve, BPB ka treguar se synon të jetë banka e zgjedhur për klientët tanë të synuar. BPB aplikoi qasjen më të mirë të mundshme për të ndihmuar klientët në zhvillimin e biznesit të tyre, duke luajtur një rol vendimtar si katalizator në mbështetje të këtij profili të klientit. Strategjia

RRITJA E VAZHDESHME E
BANKËS KA BËRË QË BPB-JA TË
ZGJEROHET NË

26 DEGË

NË TËRË KOSOVËN,
ME MBI



350
PUNËTORË

POR QË KY NUMËR PO RRIKET
DITA DITËS,
DUKE IU SHËRBYER KËSHU MBI

50,000
KLIENTËVE.

e BPB-së doli të ishte e duhura për tregun e Kosovës. BPB tashmë ofron një ekosistem biznesi për industrinë tonë bankare që i mundëson bankës dhe klientëve të guxojnë dhe të kërkojnë më shumë nga partnerët e tyre bankar dhe të biznesit. Me portfolion kreditore mbi 100 milion euro në bankingun individual, kemi arritur që t'ju mundësojmë shumë individëve e familjeve, realizimin e ëndërrave të tyre. Si pjesë vitale e këtij tregu dhe ekonomisë vendore, Banka për Biznes për dy vite me radhë është shpërblyer si banka më e

mirë në Kosovë duke marrë çmimin “The Best Bank” nga “The Banker”, publikim i prestigjiozës “Financial Times”.

Në këto 20 vite të punës edhe kërkesat por edhe shërbimet bankare kanë avancuar në mënyrë të shpejtë. BPB në vazhdimësi ka pasur mision përmbushjen e pritshmërive të klientëve dhe inovacionit për të ardhmen. Entuziazmi dhe produktiviteti në institucionin tonë bankar rrjedhin nga fryma e stafit që janë të një moshe mesatarisht të re. Kjo na mundëson që të jemi gjithmonë në hap me zhvillimet e fundit në industrinë tonë. Përveç kësaj, ajo që më bën më së shumti krenar është përfaqësimi gjinor që është i barabartë, jo vetëm në përgjithësi mirëpo edhe në nivel vendimmarrës, pra atë menaxherial. Derisa dekada e parë e punës së BPB-së ka qenë sfiduese, 10 vitet e fundit po arrijmë të jemi dëshmitarë të sukseseve që po kulmojnë me festën e këtij viti jubilar për ne. Në pamundësi që për shkak të pandemisë të festojmë së bashku, BPB nuk ka harruar partnerët e saj nga fusha e sportit, kulturës dhe shoqatave që kanë në fokus kategoritë e shoqërisë që më së shumti kanë nevojë për ndihmën tonë, fëmijët dhe gratë. Derisa po festojmë këto dy dekada, po parashikojmë edhe 20 vitet e ardhshme. BPB do të mbetet e përkushtuar ndaj misionit të saj; ne do të vazhdojmë të rritemi, ndryshojmë dhe inovojmë, duke mësuar nga ajo që ka qenë pozitive dhe e fortë në historinë dhe kulturën tonë dhe duke u përshtatur me shpejtësi në një botë në të cilën ndryshimi po përshejtohet rreth nesh në mënyrë eksponenciale.

Revolucioni i Qëndrueshmërisë për Biznesin



S iç e dinë shumë njerëz, bota është në agimin e epokës digjitale dhe të informacionit. Megjithatë, e njëjta gjë vlen edhe për qëndrueshmërinë. Ajo ka ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik për kompanitë që shkojnë drejt qëndrueshmërisë – por mos lëvizja drejt shndërrimit në një biznes të qëndrueshëm gjithashtu ka kosto. Për shembull, ekziston ideja për të qenë në anën e gabuar të çështjes për të shpëtuar planetin. Më tej, nëse konkurrentët tuaj demonstrojnë iniciativa të qëndrueshme, ju gjitha-

shtu mund të humbni fitime pasi klientët shkojnë diku tjetër.

Prandaj, le të hulumtojmë për një moment koston për bizneset rreth qëndrueshmërisë dhe pse të gjithë (si bizneset fitimprurëse ashtu edhe ato jofitimprurës) duhet të fillojnë të integrojnë qëndrueshmërinë dhe **ekonominë rrethore** në planet e tyre afariste. Le të fillojmë duke parë disa tendenca nga **Forumi Ekonomik Botëror** që vetëm ndihmojnë për të ilustruar se qëndrueshmëria nuk është vetëm gjë e mirë për t'u bërë, por për të gjitha kompanitë.

KAPACITETI I ENERGJISË SË
RIPËRTËRITSHME ËSHTË
RRITUR PËR

50%

STOQET E MAKINAVE
ELEKTRIKE JANË RRITUR
GLOBALISHT PËR MBI

900%

INVESTIMET NË BORXHIN
E QËNDRUESHËM U RRITËN
ME MË SHUMË SE

1000%

PRODUKTET E KRIJUARA DUKE PASUR
PARASYSH QËNDRUESHMËRINË RRITEN
GJASHTË HERË MË SHPEJT SE TË TJERAT.



Dështimi i madh i shumë kompanive

Sot, besoj se çdo biznes duhet të merret me qëndrueshmërinë. Por prapë, takoj njerëz që më thonë se kjo thjesht nuk do të ndodhë. Një person tha se shumica e bizneseve thjesht nuk kanë burime për t'u bërë të qëndrueshme. Pa investime, kjo do të ishte e saktë siç ka raportuar OKB-ja që bizneset e vogla kishin një shans më shumë se 2.5 herë për të dështuar dhe për të mbyllur dyert

e tyre kur goditi pandemia. Një ndërprerje e aktiviteteve të asaj përmase si rezultat i ndryshimeve klimatike mund të jetë shkatërruese për bizneset e vogla – edhe nëse ato i mbijetuan një ose dy ndërprerjeve më parë.

Prapëseprapë, ja si qëndron puna - udhëheqësit e zhvillimit të biznesit nuk mund të lejojnë të ketë mungesë të investimeve dhe vëmendjes. Kostoja e dështimit për të bërë diçka dhe e të

thënit se nuk kemi burime mund të jetë shumë më e lartë sesa riorientimi se si çdo kompani bën biznes drejt qëndrueshmërisë. Asnjë biznes nuk është një ishull më vete. Gjithçka është e ndërvarur. Që nga ky shkrim, shumë pjesë të botës po përjetojnë çmime më të larta të energjisë (paywall), duke rritur kështu koston e të bërit biznes. Një pjesë e madhe e kësaj ka të bëjë me frikën nga prodhuesit e lëndëve djegëse



Shumica e bizneseve thjesht nuk kanë burime për t'u bërë të qëndrueshme. Pa investime, kjo do të ishte e saktë siç ka raportuar OKB-ja që bizneset e vogla kishin një shans më shumë se 2.5 herë për të dështuar dhe për të mbyllur dyert e tyre kur goditi pandemia.

fosile, të cilët e dinë se bota po lëviz drejt energjisë së pastër dhe nuk duan të prodhojnë më shumë, gjë që do të ulte çmimet.

Rruga e vetme drejt ambientalizmit për bizneset

Si sipërmarrës, e kuptoj thellësisht se sa thelbësore është të shohesh shpenzimet dhe përfitimin. Unë e kuptoj këtë si udhëheqës biznesi. Megjithatë, e kuptoj gjithashtu se kompanitë dhe bizneset nuk kanë shumë zgjedhje. Konsumatorët e kuptojnë se ne jemi në telashe dhe ata po i shpenzojnë gjithnjë e më shumë paratë e tyre për kompanitë që ofrojnë qëndrueshmëri. Për shembull, si dikush në biznesin e këpucëve, shoh se si markat si Stella McCartney dhe Nike u zhvendosën drejt qëndrueshmërisë.

Me pak fjalë, ka një gjë për liderët që të bëjnë ndryshimin thelbësor drejt qëndrueshmërisë. E vetmja gjë është që duhet të formulojmë vullnetin kolektiv për të bërë ndryshim si shoqëri dhe drejtues biznesi. Realiteti është se konsumatorët e kuptojnë se kanë shumë ndikim dhe fuqi mbi markat. Për shembull, nëse markat janë në anën e gabuar të çështjeve gjinore ose racore, ato do të tërhiqen.

E njëjta gjë vlen edhe për të bërë gjënë e duhur për planetin.

Në Ditën e Tokës 2021, u shpalsën kompanitë që kishin pretenduar se ishin mbështetur në qëndrueshmëri. Ato përfshinin korporatat si Dasani, Poland Springs dhe Coca-Cola. Prisni që kjo të rritet. Klientët dhe publiku nuk po tolerojnë vërtitjen e marketingut. Ata kërkojnë veprim të vërtetë dhe kompanitë që mbështeten në të



do të lulëzojnë. Udhëheqësit duhet të krijojnë vullnetin për të bërë gjënë e duhur për planetin dhe të gjitha gjallesat. Me pak fjalë, ne duhet të gjejmë vullnet kolektiv - asgjë më pak nuk do të funksionojë.

Si mund të bëheni një aktivist udhëheqës i biznesit

Ndoshta po e lexoni këtë dhe dëshironi të bashkoheni me mua në zhvendosjen e biznesit tuaj drejt qëndrueshmërisë. Pyetja e qartë është, si? Ajo që unë do t'ju thojë të bëni është ajo që po bëj pikërisht këtu, tani. Dilni vetë dhe flisni. Bëni gjithçka në fuqinë tuaj për të ndryshuar fillimisht brenda biznesit tuaj për t'u bërë një lider mjedisor. Nëse keni nevojë, krijoni partneritet përmes aleancave strategjike për të arritur ekonomi të përshkallëzuar dhe për të ulur shpenzimet për t'u bërë të qëndrueshëm.

Pastaj, flisni në çdo mënyrë të mundshme. Nëse i përkisni një shoqate profesionale, bëhuni rrota kërcitëse dhe drejtoni ndryshimin brenda saj për kompaninë tuaj dhe shumë të tjerë. Merrni parasysh kompanitë me përgjegjësisë sociale korporative me ndërmarrjet sociale strategjike që mund t'ju sjellin atë ekspertizë. Së fundi, flisni për të brenda komunitetit dhe kompanisë suaj dhe mos ndaloni së foluri për të.

Realiteti është se shumë kompani janë në mes të një krize ekzistenciale. Nëse udhëheqësit nuk mendojnë se si të bëhen liderë dhe aktivistë mjedisorë, mund të mos ketë mjaft konsumatorë për të mbrojtur biznesin tuaj në aspektin afatgjatë.

<https://www.forbes.com/sites/forbesbusinessdevelopmentcouncil/2021/11/30/the-sustainability-revolution-for-business/?sh=f00898969f17>



Në Ditën e Tokës 2021, u shpalesën kompanitë që kishin pretenduar se ishin mbështetur në qëndrueshmëri. Ato përfshinin korporatat si Dasani, Poland Springs dhe Coca-Cola. Prisni që kjo të rritet. Klientët dhe publiku nuk po tolerojnë vërtitjen e marketingut.



ARMOND DRANQOLLI
Chief Risk Officer, Banka Ekonomike

Adresimi i risqeve përmes mundësisë së rritjes së financimit të qëndrueshëm

Plotësimi i kritereve Mjedisore, Sociale dhe Qeverisëse (ESG) është bërë prioritet për organizatat dhe Institucionet Financiare globale, pa përjashtuar edhe Institucionet Financiare që operojnë në Kosovë. Kjo sidomos, pasi që Bankat Zhvillimore (Multilateral Development Banks) dhe donatorët kanë vendosur standarde mbi bankat lokale me qëllim të adaptimit të praktikave më të qëndrueshme të financimit ndërsa investitorët po përdorin gjithnjë e më shumë kriteret e ESG-s për të vlerësuar Institucionet Financiare në të cilat ata dëshirojnë të investojnë.

Sipas raportit të vitit 2021 të publikuar nga Forumi Ekonomik Botëror (World Economic Forum), top risqet për vitin 2021 në nivel global kanë të bëjnë me mjedisin dhe ndryshimet klimatike¹. Sidoqoftë, në prespektivë, risqet mjedisore dhe klimatike do të ekspozohen edhe më shumë dhe sfidat për adresimin e tyre vetëm sa do të rriten dhe do të bëhen me komplekse dhe obligative për të gjithë akterët. Në anën tjetër, shumë organizata dhe Institucione Financiare kanë filluar me aplikimin e praktikave të ESG-së në proceset e tyre të brendshme të qeverisjes që janë të ndërlikur

me aktivitetet e tyre dhe ndikimin e tyre në aspektin mjedisor dhe social. Një ndër sfidat kryesore mbetet identifikimi dhe analizimi i risqeve materiale dhe adresimi i tyre përmes mundësisë së rritjes së financimit të qëndrueshëm duke integruar politika të shëndosha të ESG-së në aktivitetet ditore të operimit. Po ashtu, shumë nga rregullatorët dhe donatorët kërkojnë nga organizatat dhe Institucionet Financiare të shpalosin në raportet e tyre vjetore të gjitha veprimet e ndërmarra rreth politikave dhe praktikave të qëndrueshme të financimit.

Në anën tjetër, institucionet financiare luajnë rol kyç në këtë proces dhe janë përcaktues në avancimin e këtyre temave nga aspekti i financimit të sektorëve të caktuar që janë më të ndjeshme ndaj mjedisit dhe çështjeve sociale. Sidoqoftë, kjo përgjegjësi duhet të nis nga qeverisja korporative e vet Institucionit Financiar, duke filluar nga rishikimi i misionit dhe vizionit aktual, pastaj amandamentimi i politikave ekzistuese të brendshme të kreditimit duke përafruar gradualisht portofolin e saj kreditor me objektivat e ESG-së. Si rezultat, institucionet financiare duhet të in-

kurajojnë financimin e sektorëve të caktuar të ndjeshëm ndaj mjedisit dhe përkrahin kompanitë që promovojnë përmirësimin e kushteve të punës, përfshirjen gjinore dhe diversitetin në tregun e punës. Pra, të gjitha këto tema duhet adresuar dhe adaptuar në politikën ditore e të bërit biznes.

Në anën tjetër, qeveria qendrore dhe lokale ka rol kyç në zhvillimin e strategjisë dhe ligjeve të nevojshme që promovojnë dhe stimulojnë një qasje me pro-aktive rreth temave të ESG-së pasi që këto iniciativa do të përshpejtojnë adaptim më gjithëpërfshirës të të gjitha palëve në këtë synim.

Po ashtu, qeveria përmes emetimit të instrumenteve financiare (green bonds) mund të alokojë mjete financiare direkte të cilat mund të përdoren për financimin e projekteve që kanë përfitime direkte mjedisore dhe sociale. “Në fund, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi për kalimin nga sistemi financiar tradicional në një sistem të qëndrueshëm financiar dhe për këtë arsye të gjithë duhet të punojmë së bashku për arritjen e këtij qëllimi”.

¹ https://www.weforum.org/docs/WEF_The_Global_Risks_Report_2021.pdf

Tabela 1. Trendi i Reziqeve dhe Probaliteti sipas Raportit Botëror të Risqeve 2021, edicioni i 18-të



20 VITE
—
BESIM DHE
PARTNERITET



**Banka
Ekonomike**

Vjetërsia: mbi 2000 vjet - Monedhë autentike
- Vjetërsia: mbi 2000 vjet - Monedhë autentike
- Vjetërsia: mbi 2000 vjet - Monedhë autentike



**JETON SHATRI**

Koordinator për Risk & Koordinator për ESG, NLB Banka Prishtina

**MIRSAD HASKAJ**

Zyrtar Kryesor për Risk & Zyrtar për ESMS, NLB Banka Prishtina

Rruga drejt financimit të qëndrueshëm

Kalimi në një **ekonomi të qëndrueshme** është pa dyshim sfida e kohës sonë. Emetimet gjithnjë në rritje të gazrave serrë po ngrohin planetin, po ndryshojnë klimën dhe po kërcënojnë jetën e njerëzve. Me krizën e Koronavirusit, u bë edhe më e qartë se bankat duhet të përshpejtojnë financimin e një ekonomie me karbon të ulët dhe në të njëjtën kohë të zhvillojnë një vizion se si duhet të duket një bankë progresive ndaj klimës. Kosova si një nga vendet më të ndotura në Evropë mbetet shumë e prekur për shkak të termocentralit të saj me thëngjill, trafikut të automjeteve me naftë dhe sistemit të ngrohjes shtëpiake me dru dhe thëngjill, prandaj, iniciativat e ndërmarra nga bankat drejt fillimit të politikave të ESG-së (Mjedisore, Sociale, të Qeverisjes) në operimet e tyre kanë qenë të një rëndësie të madhe.

Termi qëndrueshmëri u përkufizua fillimisht zyrtarisht në vitin 1987 nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara Brundtland si “*përmbushja e nevojave të së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre*”. Koncepti i qëndrueshmërisë përbëhet nga tri shtylla: **ekonomike, mjedisore dhe sociale - të njohura gjithashtu si përfitimet, planeti dhe njerëzit.**

QEVERIA E KOSOVËS
U ZOTUA PËR
PËRMBUSHJEN E
OBJEKTIVAVE TË
DETYRUESHME TË

BRE-SË
(BURIMET E
RIPËRTËRITSHME TË
ENERGJISË),

TË CILAT ISHIN
PËRCAKTUAR DHE
MIRATUAR NGA
KËSHILLI MINISTOR
I KOMUNITETIT TË
ENERGJISË. ANGAZHIMI
I DETYRUESHËM ËSHTË
ARRITJA E



TË KONSUMIT FINAL
BRUTO TË ENERGJISË.

Institucionet financiare po miratojnë gjithnjë e më shumë standarde globale për menaxhimin e rizikut mjedisor dhe social dhe për zhvillimin e produkteve të qëndrueshme financiare. Për institucionet financiare, qëndrueshmëria ka dy komponentë:

➔ **Menaxhimi i rreziqeve mjedisore dhe sociale (E&S):** institucionet financiare mund të forcojnë portofolin e tyre duke vlerësuar sistematikisht rreziqet e E&S të aktiviteteve të kreditimit dhe investimit për të minimizuar rreziqet financiare, të detyrimeve dhe të reputacionit që rrjedhin nga çështjet e E&S.

➔ **Identifikimi dhe shfrytëzimi i mundësive mjedisore të biznesit** për zhvillimin e produkteve inovative në fusha të reja që lidhen me qëndrueshmërinë përfshin krijimin e produkteve dhe shërbimeve financiare që mbështesin aktivitetet tregtare me përfitime të E&S.

Modelet e biznesit që trajtojnë këto dy dimensionet po ndihmojnë institucionet financiare të diferencohen nga konkurrentët, të përmirësojnë reputacionin e tyre në mesin klientëve dhe palëve kryesore të interesit, të tërheqin kapital të ri dhe të gjenerojnë vullnet të

mirë dhe mbështetje nga palët e interesit përmes rritjes së transparencës.

BE-ja zhvilloi një ombrellë - **Marrëveshja e Gjelbër Evropiane dhe plani i veprimit i BE-së për financim të qëndrueshëm**, për të krijuar një gjuhë të përbashkët për financim të qëndrueshme dhe investime të qëndrueshme dhe afatgjata, të cilat, së bashku me kërkesën për pjesëmarrësit e tregut financiar për të shpalosur shkallën e qëndrueshmërisë mjedisore të produkteve të tyre, nënkupton se BE-ja po udhëheq evolucionin drejt investimeve të qëndrueshme dhe afatgjata.

Plani i veprimit të BE-së për financim të qëndrueshëm u miratua nga Komisioni Evropian në mars të vitit 2018 dhe është pjesë e udhërrëfyesit të KE-së, i njohur gjithashtu si Marrëveshja e Gjelbër Evropiane, që synon zbutjen e ndryshimeve klimatike, reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Plani i veprimit i BE-së më qëllim të financimit të qëndrueshëm është kanalizim i flukseve financiare private drejt investimeve që mbështesin:

- Objektivin e **Marrëveshjes së Parisit** të OKB-së për një ekonomi neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050,
- dhe më gjerësisht **Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara**.

Bankat mund të menaxhojnë ekspozimin e tyre ndaj rreziqeve të E&S duke zhvilluar një **Sistem të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS)**. Kjo ndihmon bankën që të ulë ekspozimin e saj ndaj rrezikut të përgjithshëm. Në rastin e një banke, ESMS-ja përbëhet nga komponentët, siç janë politika e E&S e bankës, procedurat, angazhimi i menaxhmentit dhe stafi i caktuar me përgjegjësi të qarta për zbatim.

Sektori Bankar i Kosovës vazhdimisht po ndërgjegjësohet ndaj ESG-së, ku sot shumica e bankave në Kosovë me kapital të huaj tashmë kanë miratuar ESMS-në



Projektet e mëdha po mbështeten nga bankat me qëllim të financimit të qëndrueshëm. **SOWI Kosovo L.L.C** është një nga fermat më të mëdha të turbinave me erë (e përbërë nga 37 turbina me erë) në rajon dhe në të njëjtën kohë IHD-të më të mëdha në Kosovën e pasluftës përfaqësojnë një nga rastet ku NLB Banka j.s.c. Prishtina së bashku me NLB d.d, BERZH-in dhe Erste Bank kanë bashkë-financuar projektin

me kosto totale të investimit prej
169 milion euro.

ashtu siç janë këshilluar nga bankat e tyre amë, ndërkohë që bankat vendore janë në rrugën e duhur për vendosjen e një sistemi të tillë dhe shumë prej tyre i janë përkushtuar financimit të gjelbër duke ofruar të ashtuquajturat kredi të gjelbra. Nga ana tjetër, Qeveria e Kosovës u zotua për përmbushjen e objektivave të detyrueshme të BRE-së (burimet e ripërtëritshme të energjisë), të cilat ishin përcaktuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrorëve dhe Komunitetit të Energjisë. Angazhimi i detyrueshëm është arritja e 25 për qind të konsumit final bruto të energjisë.

Në vitin 2020, NLB Group hyri në rrugën e integritimit më intensiv të qëndrueshmërisë në operacionet bankare së bashku me ngjarjen nënshkruese të Parimeve të OKB-së për Banking të Përgjegjshëm, gjithashtu, CSR e NLB Group është përmirësuar vazhdimisht me projekte që ndjekin **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OZHQ të OKB-së)**.

Pandemia e Covid-19 ka forcuar agjendat bankare në lidhje me menaxhimin e rrezikut klimatik dhe në këtë mënyrë është ndërmarrë një zbatim më gjithëpërfshirës i faktorëve të ESG-së.

ESG paraqet një sfidë të re për sektorin bankar, pasi që është bërë më se e qartë se politika e CSR-së (Përgjegjësia Sociale Korporative) e shtrirë vetëm në fushën e mbrojtjes së mjedisit thjesht nuk do të mjaftojë.

Bankat janë një komponent thelbësor i ekosistemit të ESG-së, kalimi në një bankë të qëndrueshme kërkon përshtatjen e shumicës së proceseve bankare, si dhe ndryshime në kulturën bankare, megjithëse përfitimet e një përshtatjeje të tillë sigurisht që do të shpërblehen ndërsa ne përpiqemi për një të ardhme më të mirë për shoqërinë dhe planetin tonë.

**FATMIRE IMERAJ**

Specialiste për Financim të Qëndrueshëm, Raiffeisen Bank Kosovo

Financim i Qëndrueshëm – Ndikimi në ekonomi dhe shoqëri

Ndryshimi klimatik është një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë. Pasojat e tij mund të rezultojnë në ndikime shkatërruese dhe afatgjate në ekonomi dhe shoqëri. Në këtë mënyrë, si rezultat i kësaj, roli i financimit në mundësimin e një modeli ekonomik me klimën në qendër është jetik.

Prandaj, nuk është për t'u habitur që tema e financimit të qëndrueshëm ka tërhequr vëmendjen gjatë dekadës së fundit.

Financimi i qëndrueshëm i referohet procesit të marrjes parasysh të çështjeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) kur merren vendime për investime në sektorin financiar, duke çuar në më shumë investime afatgjate në aktivitete dhe projekte ekonomike të qëndrueshme.

FINANCIMI I QËNDRUESHËM

DO TË NDIHMOJË PËR TË
SIGURUAR QË INVESTIMET
MBËSHTESIN



NJË EKONOMI TË
QËNDRUESHME DHE
NJË RIMËKËMBJE TË
QËNDRUESHME NGA
NDIKIMET E PANDEMISË



COVID-19.

Financimi i qëndrueshëm luan rol kyç në arritjen e objektivave të politikës sipas marrëveshjes së gjelbër evropiane, si dhe të përkushtimeve ndërkombëtare të BE-së për objektivat e klimës dhe qëndrueshmërisë. Ai e bën këtë duke kanalizuar investimet private në kalimin drejt një ekonomie neutrale ndaj klimës, të qëndrueshme ndaj klimës, efiçiente ndaj burimeve dhe ekonomie të drejtë, si një plotësues i parasë publike. Financimi i qëndrueshëm do të ndihmojë për të siguruar që investimet mbështesin një ekonomi të qëndrueshme dhe një rimëkëmbje të qëndrueshme nga ndikimet e pandemisë COVID-19. (Burimi: Komisioni Evropian 2021).



RBI GROUP

ËSHTË BËRË NËNSHKRUES
ZYRTAR I PARIMEVE TË

OKB-SË

PËR BANKING TË
PËRGJEGJSHËM,

DUKE PËRQAFUAR KËSHU
SHUMICËN E OBJEKTIVAVE TË
OZHQ-SË QË DALIN NGA KONVENTA
E PARISIT PËR OBJEKTIVAT E
ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM.



MEGJITHËSE MUND TË DUKET SI NJË KONCEPT I RI, FINANCIMI I QËNDRUESHËM
KA QENË PREJ KOHËSH PJESË E RRËNJOSUR THELLË E RAIFFEISEN

(PËR MË SHUMË SE 130 VITE)

MEGJITHATË, VITET E FUNDIT, EVOLUIMI DHE ZBATIMI I TYRE ËSHTË PËRSHPËJTUAR
DUKE QENË SE KANË VLERA SHUMË TË KËRKUARA NGA SHOQËRIA.

Pasojat e ndryshimeve mjedisore i shohim prej kohësh dhe ndër të tje-
ra, ato po ndikojnë edhe në aspektin
social në mbarë globin. Si rezultat,
qeveritë, organizatat dhe industritë
e ndryshme po e zhvendosin foku-
sin e tyre drejt qëndrueshmërisë.

Komuniteti financiar global është
i përkushtuar të ndërmarrë veprime
dhe të rrisë nivelin e investimeve
në projekte të qëndrueshme duke
marrë parasysh çështjet mjedisore,
sociale dhe të qeverisjes (ESG)
kur merren vendime për investime,
duke çuar në aktivitete dhe projekte
më të qëndrueshme ekonomike.

RBI Group është bërë nëns-
hkrues zyrtar i Parimeve të OKB-
së për Banking të Përgjegjshëm,
duke përqafuar kështu shumicën e
Objektivave të OZHQ-së që dalin nga
Konventa e Parisit për Objektivat e
Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Megjithëse mund të duket si një
koncept i ri, financimi i qëndrues-
hëm ka qenë prej kohësh pjesë e

rrënjosur thellë e Raiffeisen (për
më shumë se 130 vite). Megjithatë,
vitet e fundit, evoluimi dhe zbatimi
i tyre është përsheptuar duke qenë
se kanë vlera shumë të kërkuara nga
shoqëria.

Raiffeisen Bank në Kosovë synon
të ofrojë produkte dhe shërbime
të qëndrueshme financiare për të
mbështetur klientët tanë në tran-
sformimin e tyre drejt një të ardh-
meje të qëndrueshme dhe për këtë
arsye për të dhënë gjithashtu kon-
tribut pozitiv për shoqërinë duke
drejtuar flukset financiare në përp-
uthje me rrugën drejt emetimeve të
ulëta të gazrave serrë dhe zhvillimit
të qëndrueshëm ndaj klimës.

Duke pasur parasysh se ESG është
një nga prioritetet e bankës sonë, po
punojmë vazhdimisht për rritjen e
ndërgjegjësimit për të ndërtuar një
bazë të përbashkët të njohurive për
çështjet mjedisore sociale dhe të qe-
verisjes, duke organizuar një sërë
seancash trajnimi dhe seminare,

Rezultat/Vlerësim të ESG-së, ekza-
minim paraprak të portofolit tonë
si dhe stimuj.

Raiffeisen Bank në Kosovë e sheh
bankingun e qëndrueshëm si faktor
kyç në gjenerimin e rritjes së biz-
nesit në të ardhmen. Vlerat tona
bankare bazohen në fitim me qëllim
që të marrin në konsideratë ndiki-
min mjedisor dhe social. Në këtë
drejtim, ne përpikemi të ofrojmë
produktin më të dobishëm kredi-
tues, të përafuar me praktikën më
të mira të industrisë dhe në përp-
uthje me kërkesat rregullative për
aktivitetin e industrisë së përshtat-
shme neutrale ndaj karbonit për ta-
ksonominë e BE-së. Ne mbështesim
klientët tanë për të financuar aktivi-
tete që kontribuojnë në qytete dhe
komunitete të qëndrueshme, mena-
xhim të mbeturinave, energji të gjel-
bër, menaxhim të ujërave, ekonomi
rrethore, ndërtesa të gjelbra, kujdes
shëndetësor, diversitet, arsim, etj.

TRANSFERO PARA SHPEJT DHE SIGURT PËRMES **KODIT QR!**

Krijo kodin tënd përmes
SmartPay në **BKT Mobile**.



Skeno QR Code



BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

CALX HOLDING
40th

038 666 666 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!



ARBËRIE PACOLLI

Koordinatorë e Hipotekës dhe Lizingut të Pasurive të Paluajtshme,
Banka Ekonomike,

Industria bankare dhe roli i saj drejt financimit të qëndrueshëm

Industria bankare ka rol për të përmirësuar dhe shtyrë industrinë tonë financiare drejt financimit të qëndrueshëm dhe për të rrënjësuar këto vlera thelbësore në tërë sektorin privat dhe publik.

Është vërtetuar se liderët janë ata që inicijojnë ndryshimin dhe udhëheqin me shembuj. Industria bankare ka qenë lider në ofrimin e profesionistëve, kulturës korporative dhe inovacionit në vendin tonë. Bankierët e Kosovës arrijnë suksese në sektorin privat dhe publik kur preferojnë të ndryshojnë karrierën. Sot ish-bankarët janë ata që drejtojnë korporata, fintech kompani, projekte strategjike, ndërmarrje publike, kompani konsulente dhe janë juristë të njohur. “Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon zgjuarsis njerëzore. Njerëzit janë burimi më i rëndësishëm.” Prandaj, industria jonë bankare ka rol për të përmirësuar dhe shtyrë industrinë tonë financiare drejt financimit të qëndrueshëm dhe për t’i rrënjësuar edhe një herë këto vlera thelbësore të tërë sektorin privat dhe publik.

Ne avokojmë fuqimisht se çdo ndryshim i vogël ka rëndësi. Duke filluar nga procesi i rekrutimit dhe punësimi i gjeneratës së re të bankierëve që do të rrënjësin financimin e qëndrueshëm si tipar kryesor të fushës së tyre profesionale. Dhe kujdesi duhet të vazhdojë në punën tonë të përditshme duke zhvilluar produkte të bazuara në financim të qëndrueshëm, duke krijuar fushata marketingu që do të synojnë klientët që do të përqafojnë mënyrën e re të bankingu të përgjegjshëm. Edhe duke vizituar një klient afarist në një korporatë që përdorë automjete hibride, për t’i promovuar dhe

për t’u ofruar atyre një marrëveshje shumë tërheqëse për të ndryshuar flotën e tyre të transportit nga ajo e drejtuar me karburant në atë me energji eficientë.

Bankingu klasike nuk është më çështje dhe banka është ngritur në një partneritet ndërmjet palëve. Pra, banka krijon një marrëdhënie partneriteti me klientin, por edhe me palët e treta si furnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët, etj. Për të kontribuar drejt financimit të qëndrueshëm gjatë përzgjedhjes së partnerëve tanë afarist, ne duhet të zgjedhim me kujdes ata që ndajnë të njëjtat vlera drejt krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm financiar. Krijimi i një sinergjie drejt një të ardhmeje të gjelbër dhe të qëndrueshme është prioritet dhe detyrë ndaj komunitetit tonë shoqëror. Në këtë mënyrë, partneriteti jo vetëm që do të zgjasë më shumë, por do të sjellë edhe qasje inovative ndaj produkteve dhe shërbimeve në dispozicion të shoqërisë tonë.

Duke marrë parasysh bumin e fundit të infrastrukturës në Kosovë, shumë agjentë të pasurive të paluajtshme në partneritet me kompanitë ndërtimore kanë bashkuar forcat për të ndërtuar apartamente, shtëpi private e madje edhe lagje. Bankat kanë zgjedhjen për të mbështetur ata që do të ndikojnë drejtpërdrejt në financimin e qëndrueshëm dhe për t’u ofruar qytetarëve të Kosovës një rregullim jetese sipas standardeve më të ngritura eko-miqësore

dhe ergonomike. Prandaj, duke siguruar fonde për këto projekte miqësore për mjedisin, bankat po kontribuojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë financiare; për më tepër, duke ndihmuar profesionistët e arkitekturës në krijimin e një standardi më të lartë ndërtimi.

Siç u tha më herët, një produkt dhe shërbim i projektuar mirë luan rol të madh në hapjen e rrugës për financim të qëndrueshëm. Së fundi në Kosovë, bankat kanë krijuar produkte me kushte preferenciale për investim në energjinë e gjelbër, rrjetin inteligjent, gratë në biznes, start-upet për të rinjtë ndërmarrës dhe kauza të tjera. Edhe një herë, mund të themi se bankat luajnë rol shumë aktiv në mbështetjen e sektorit privat dhe kontribuojnë në kulturimin e shoqërisë sonë drejt standardeve më të ngritura afariste.

Banka është një industri me shumë ritëm dhe inovative, por në Kosovë është një gur themeli në formësimin e planeve dhe rritjes afatgjatë të sektorit privat. “Sigurimi i një të ardhmeje të qëndrueshme kërkon që të gjithë ne të punojmë së bashku”. Prandaj, duhet të ndihemi të përgjegjshëm dhe llogaridhënës ndaj mbështetjes së financimit të qëndrueshëm, duke ofruar produkte që janë të destinuara për të përmbushur jo vetëm nevojat e klientëve, por edhe shoqërisë kosovare.

**FATOS HASANI**

Udhëheqës i njësisë për menaxhimin
mjedisor, Banka ProCredit Kosovë

Tranzicioni energjetik dhe investimet në burime të energjisë diellore në Kosovë

Në Kosovë, konsumi i energjisë elektrike është kontribuesi kryesor në emetimin e gazrave serrë dhe dioksidit të karbonit për sektorin e industrisë, atë komercial dhe ekonomive familjare. Ky kontribut ndërlidhet me faktin që 95% e prodhimit të energjisë elektrike sigurohet nga thëngjilli ose linjiti, ndërsa pjesa tjetër nga burimet e ripërtëritshme. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike sot prodhohet nga termocentralet me teknologji të vjetëruar, rrjedhimisht me një kosto të ulët prodhimi dhe me besueshmëri të lartë. Rreth 5% e kapacitetit të instaluar është nga prodhimi i energjisë së ripërtëritshme.

Megjithatë, në njërën anë, shqetësimet për qëndrueshmërinë afatgjatë të prodhimit të bazuar në lëndë djegëse fosile, veçanërisht shqetësimet e ndërlidhura me ndryshimet klimatike dhe kostot e ardhshme mjedisore kryesisht të pa llogaritura, po e shtojnë industrinë energjetike drejt burimeve të qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme, me emetim të ulët të dioksidit të karbonit. Pritjet e komunitetit të energjisë për këtë ndryshim janë të larta dhe politikat qeveritare gjitha-

shtu duhet të shtojnë industrinë energjetike në këtë drejtim.

Në anën tjetër, duket sikur jemi duke shkuar drejtë një krize globale energjetike. Evropa që nga shtatori 2021 është duke u përballur me rritje të çmimit të energjisë elektrike deri në 230%. **Pse është duke ndodhur kjo?** Shpjegimi më i thjeshtë është sepse kërkesa për energji aktualisht është duke tejkaluar ofertën, gjë që

bën çmimet të rriten. Arsyet për këtë janë nga më të ndryshmet duke filluar nga rritja e çmimit të gazit, ringjallja e ekonomisë pas COVID-19, rritje e taksës së karbonit për 76% (nga 34 Euro në mes të janarit 2021 në gati 60 Euro në tetor 2021). Për më tepër shumë vende në botë për qëllime të mira dhe të mirëseardhura mjedisore kanë ndaluar të investojnë në lëndë djegëse dhe siç duket deri më tani



EVROPA

QË NGA SHTATORI 2021 ËSHTË DUKE U PËRBALLUR ME RRIJTE TË ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DERI NË

230%

PSE ËSHTË DUKE NDODHUR KJO?

SHPJEGIMI MË I THJESHTË ËSHTË SEPSE KËRKESA PËR ENERGJI AKTUALISHT ËSHTË DUKE TEJKALUAR OFERTËN, GJË QË BËN ÇMIMET TË RRIJEN.

nuk ka energji të pastër/ ripërtëritshme të mjaftueshme për të zëvendësuar lëndët djegëse.

Kuptohet që shoqëritë moderne nuk mund të funksionojnë pa qasje të qëndrueshme në energji, andaj edhe kur krizat të tilla ndihen, qeveritë bëjnë çdo gjë që është e mundur që të ofrojnë energji elektrike. Andaj shqetësimi shtohet se ato mund të ridrejtohen në përdorimin e lëndëve djegëse duke krijuar kontradikta gjatë themelimit të strategjive.

Aktualisht tregu i energjisë në Kosovë është shumë i varur nga prodhimi i energjisë nga lëndët djegëse fosile dhe kjo e bën Kosovën me miksin më të keq të energjisë elektrike në rajon për nga aspekti i ndikimit në mjedis dhe shoqëri. Për këtë fakt, dhe duke qenë se Kosova importon energji elektrike mesatarisht prej 12–18% në vit, **Kosovës i duhet një strategji serioze e tranzicionit energjetik, strategji e cila do të njoh faktin se duhet reduktuar emetimet e dioksidit të karbonit shpejtë dhe rrjedhimisht të menaxhohet rritja e çmimit të energjisë elektrike (i cili duket i paevitueshëm) në mënyrë graduale.**

Andaj, për të kaluar tranzicionin energjetik, Kosova medoemos duhet të rris

kapacitetet e prodhimit duke bërë një miks nga të gjitha burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Nga energjitë e ripërtëritshme, energjia diellore është zgjidhja që ofron më së shumti mundësi për zvogëlimin e emetimit të gazrave serrë për të ndihmuar në luftimin e ngrohjes globale dhe në përgjithësi për të ofruar potencial të lartë në prodhimin e energjisë elektrike. Fatkeqësisht, nga prodhimi total i energjisë elektrike në Kosovë (përfshirë sistemet jashtë rrjetit elektrik) vetëm 1% është nga energjia diellore.

Teknologjia e energjisë diellore e cila mbështetet në një burim të pashtershëm të energjisë primare, është e dëshmuar teknikisht dhe tashmë ofron arsyeshmëri ekonomike të investimit duke ofruar mundësi të përdoret nga të gjitha nivelet e një shoqërie, që nga ai institucional, industrial dhe së fundmi nga individë privat apo ekonomitë familjare.

Këto investime kanalizohen përmes:

- 1 Centraleve të mëdha dhe të centralizuara të prodhimit të energjisë
- 2 Sisteme fotovoltaike më të vogla të shpërndara ose decentralizuara

ARSYET PËR KËTË JANË NGA MË TË NDRYSHMET DUKE FILLUAR NGA RRIJTA E ÇMIMIT TË GAZIT, RINGJALLJA E EKONOMISË PAS COVID-19, RRIJTE E TAKSËS SË KARBONIT PËR

76%

- 3 Dhe në shkallë të ulët, në nivel të konsumatorit individual - sistemet fotovoltaike në kulme për vetëkonsum.

Për fund, theksoj se për bankën Pro-Credit minimizimi i ndikimit negativ në mjedis dhe promovimi proaktiv i një mënyre të qëndrueshme të të bërit biznes është një pjesë përbërëse e strategjisë sonë. Marrë parasysh impaktin që kanë investimet e sistemeve fotovoltaike në reduktimin e gazrave serrë, ne si bankë kemi qenë proaktiv në treg që nga viti 2017 duke promovuar dhe financuar këto investime.

Sipas vlerësimit tonë të brendshëm, deri në nëntor 2021 ne kemi financuar 60% të kapacitetit të instaluar në sisteme fotovoltaike për vetëkonsum në Kosovë, nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Gjithsej 57 projekte me kapacitet të instaluar prej 9,7 Mwp.

Ne vazhdimisht investojmë në kualifikim të stafit duke krijuar ekspertizë të lartë, gjë që na ka mundësuar që të jemi lider të tregut në financim të sistemeve solare, dhe gjithashtu të jemi katalizator të tranzicionit të qëndrueshëm energjetik.

**GENTIANA HALIMI**

Specialiste e Lartë e Departamentit të Institucioneve Financiare,
Banka Kombëtare Tregtare Kosovë

Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm drejt financimit të qëndrueshëm

Në ditët e sotme, tema mbi financimin e qëndrueshëm është evidentuar në shumë vende për shkak të rëndësisë së saj në proceset mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG). Financimi i qëndrueshëm në kontekstin e Bashkimit Evropian kuptohet si financim për të mbështetur rritjen afatgjate ekonomike duke ulur presionin mbi mjedisin dhe duke marrë parasysh aspektet sociale dhe të qeverisjes¹. Nga këndvështrimi i OKB-së, financimi i qëndrueshëm kontribuon drejtpërdrejt dhe tërthorazi në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG).

Tema e financimit të qëndrueshëm në shumicën e rasteve lidhet me procesin e ESG-së. Duke u dhënë prioritet ESG-së, financimi i qëndrueshëm krijon vlerë përmes formësimit të agjendës së qeverive, rregullatorëve, organizatave financiare dhe jofinanciare për të garantuar efikasitetin ekonomik të vendit. Për më tepër, vlerësime të tilla bëhen duke marrë parasysh ndërveprimet me mjedisin/sistemin ekologjik, duke konsideruar elementin social dhe duke promovuar mirëqenien sociale dhe faktorin e qeverisjes përmes politikave

dhe vendimmarrjes. Akronimi ESG mund të shpjgohet më tej si:

→ Mjedisore, e cila është thelbësore për një jetë të shëndetshme duke reaguar shpejt ndaj ndryshimeve klimatike, emetimit të gazit, produkteve të gjelbra dhe energjisë së ripërtëritshme.

→ Sociale, një element që përshkruan çështje komplekse që lidhen me punonjësit, privatësinë e të dhënave, diversitetin kulturor dhe drejtësinë sociale.

→ Qeverisje që nënkupton qeverisjen e mirë korporative dhe të mirë me rregulla, procese që një vend/kompani përdor për të marrë vendime.

Performanca e ESG-së krijon avantazhe krahasuese që rezultojnë në krijimin e vlerës dhe uljen e rrezikut për vendin/kompaninë/institucionin nëse integrohen kritere të tilla.

Financimi i qëndrueshëm për vendet në zhvillim mund të jetë një sfidë për shumë arsye, siç janë mungesa e investimeve të huaja, mjedisi i pafavorshëm

afarist, institucionet e dobëta, pra duke ofruar një mjedis miqësor ndaj biznesit, duke inkurajuar aktivitetin afarist dhe duke përmirësuar/ngritur llogaridhënien e institucioneve që mund të luajnë një rol të rëndësishëm për mobilizimin e financimit të qëndrueshëm.

Vendet në zhvillim mund të përfitojnë nga financimi i qëndrueshëm duke arritur performancë më të mirë nëpërmjet ndërtimit të një kornize të përshtatshme të ESG-së. Krijimi i një kornize të tillë në vend, ndihmon vendin/kompaninë/institucionin të menaxhojë aspektet e ESG-së që potencialisht rezultojnë në rritje afatgjatë. Të tri komponentët e ESG-së kanë ndikim në funksionimin më të qetë dhe entuziazmin e tregut, të cilat prodhojnë rezultate pozitive përtej performancës të mirë financiare.

Kosova, si vend në zhvillim, duhet të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm, duke u fokusuar në financim të qëndrueshëm dhe duke krijuar një kornizë të ESG-së e cila do të ketë ndikim afatgjatë për ekonominë dhe vetë vendin.

¹ Uebfaqja zyrtare e Bashkimit Evropian; https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/banking-and-finance/sustainable-finance/overview-sustainable-finance_en



VISAR PAÇARADA

Anëtar i bordit menaxhues,
ProCredit Bank Kosova

Si bëhet menaxhimi mjedisor dhe social nga një bankë e përgjegjshme?

Banka ProCredit në Kosovë si pjesë grupit të Bankave ProCredit, është e orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit. Ne vazhdimisht rivlerësojmë rëndësinë e veprimeve dhe aktiviteteve tona në raport me konceptin tonë të zhvillimit i cili shkon përtej fokusit të vetëm të rritjes ekonomike në kuptimin tradicional të saj. Përkundrazi, veprimet tona i rivlerësojmë në raport me përgjegjësinë më të gjerë ndaj vendeve në të cilat grupi ProCredit vepron. ProCredit vazhdimisht i vlerëson veprimet dhe vendimet, jo vetëm nga perspektiva e përfitimit dhe nevojave të klientëve tanë, por edhe dhe mbi të gjitha nga ndikimi që mund të kenë në shoqërinë dhe mjedisin rreth nesh.

Minimizimi i ndikimit negativ në mjedis dhe promovimi proaktiv i një mënyre të qëndrueshme të bërjes së biznesit është një pjesë përbërëse e strategjisë sonë - jo vetëm në lidhje me operacionet tona të huadhënies apo sigurimin e shërbimeve financiare për klientë, por edhe në veprimet tona ditore.

Për të arritur këtë, ne kemi zhvilluar dhe zbatuar një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të mjedisit të certifikuar me standardin ISO 14001. Ky sistem është i implementuar që nga viti 2008 dhe bazohet në tre shtylla, dhe jo vetëm që ka për qëllim zvogëlimin e ndikimit të brendshëm dhe të jashtëm mjedisor të bankës ProCredit por edhe promovon

NË NËNTOR TË VITIT 2021,
PORTOFOLI I KREDIVE
TË GJELBRA PËR GRUPIN
PROCREDIT KA TEJKALUAR
VLERËN PREJ

**1 MILIARD
EURO**

OSE MBI

20%

E TOTAL PORTOFOLIT
TOTAL TË GRUPIT,
KURSE VETËM NË
KOSOVË KA QENË

**98,5 MILION
EURO**

APO

17%

E PORTOFOLIT TË
PËRGJITHSHËM TË
KREDIVE.

kredi dhe investime të qëndrueshme që kanë një ndikim pozitiv në mjedis.

Cilat janë këto tre shtylla?

➔ **Menaxhimi i brendshëm mjedisor** ka të bëjë me të gjitha masat e brendshme të marra në institucion për të reduktuar ndikimin mjedisor të bankës. Në mënyrë që të përmirësojmë ndikimin e brendshëm mjedisor, është e rëndësishme që fillimisht të përcaktohen indikatorët kuantitativ që bëjnë të mundshme matjen, vlerësimin dhe caktimin e objektivave për përmirësimin e performancës mjedisore. ProCredit banka sot ka sistem të sofistikuar dhe është në gjendje ta matë dhe monitorojë me saktësi këta indikatorë sikurse lirimi i gazrave serrë, konsumi i ujit etj. Ndër vite ne vazhdimisht kemi ulur shpenzimin e energjisë elektrike duke investuar në masa dhe pajisje efçente në ndërtesat tona, duke mos anashkaluar edhe investimet në pajisje fotovoltaike e cila kompenson një pjesë të konsiderueshme të faturës së energjisë elektrike për zyrën tonë qendrore. Ne kemi ulur në mënyrë domethënëse përdorimin e letrës duke investuar në teknologji të nënshkrimit digjital, kemi zvogëluar konsumin e ujit duke investuar në pajisje të mençura si dhe në ngritjen e vetëdijes të stafit tonë.

Për më tepër kemi zëvendësuar flotën e veturave lëndë djegëse në ato elektrike,

kështu duke kontribuar në reduktimin e gazrave serrë dhe emetimit të dioksidit të karbonit. Si bankë po ashtu jemi përkujdesur që të mundësojmë infrastrukturë për mbushjen e veturave elektrike edhe për publikun e gjerë, duke investuar në 25 stacione elektrike në tërë territorin e Kosovës.

Objektiva jonë afatmesme është që deri në vitin 2023 të bëhemi institucion karbon-neutral. Për të arritur këtë objektivi, si masë shtesë për të ulur ndikimin negativ në mjedis - me shpresën se do nxisim investime të tilla edhe nga institucionet apo bizneset që veprojnë në Kosovë - aksionari kryesor i Grupit të Bankave ProCredit, ProCredit Holding, ka ndërmarrë iniciativë për investim në Kosovë, në projekt të prodhimit të energjisë elektrike nga energjia diellore me kapacitet prej 3Mw me një vlerë investive rreth 2,2 Milion Euro. Banka ProCredit zotohet se pas përfundimit të këtij projekti e tërë energjia elektrike që konsumohet nga institucioni do të jetë nga burime të ripërtëritshme, gjegjësisht nga energjia diellore. **Arsyeja e përzgjedhjes së Kosovës për këtë investim është fakti që në Kosovë rreth 95% e energjisë elektrike prodhohet nga thëngjilli që përdoret në dy termocentrale shumë të vjetra, ku për çdo kilovat të energjisë elektrike të prodhuar lirojnë rreth 1 kg CO².** Andaj ne konsiderojmë, çdo investim në energji të ripërtëritshme është investim direkt në shëndetin e shoqërisë dhe gjeneratave që vijnë pas.

Po ashtu, përveç investimeve që kanë ndikim direkt apo indirekt në reduktim të emetimit të gazrave serrë, ne vazhdimisht investojmë edhe në masa tjera siç janë mbjellja e drunjëve, ku deri më tash kemi mbjellë mbi 1,000 drunj ku janë gjelbëruar 128,000 m². Të gjitha këto arritje ne i raportojmë në mënyrë të vazhdueshme sipas standardit (GRI) Iniciativa Globale Për Raportim .

→ **Menaxhimi i rrezikut mjedisor dhe social gjatë kreditimit.** Ne jemi të përkushtuar për të financuar projekte të shëndosha mjedisore dhe shoqërore dhe punojmë vetëm me kompanitë që nuk e vënë mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e stafit të tyre në rrezik. **Ne nuk i financojmë aktivitetet që kanë ndikim negativ të pariparueshëm në mjedis dhe shoqëri duke i renditur ato në listë të aktiviteteve përjashtuese.** Shembuj: Ne nuk financojmë bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zona të mbrojtura, kultivimin dhe prodhimin e duhanit dhe alkoolit, aktivitetin e minierave etj. Përveç kësaj, ne vlerësojmë rrezikun mjedisor dhe social në lidhje me çdo kërkesë për financim nga bizneset. Në këtë fushë, objektiva jonë afatmesme është që të mirëmbajmë dhe të rrisim më tutje nivelin e lartë të kompetencës mjedisore dhe

sociale të stafit tonë në mënyrë që vazhdimisht të i mbështesim klientët tanë drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

→ **Financimi i gjelbër.** Kemi hartuar dhe promovuar kreditë e gjelbra për të mbështetur investimet në efikasitet të energjisë, energjinë e ripërtëritshme dhe mbrojtjen e mjedisit. Në nëntor të vitit 2021, portofoli i kredive të gjelbra për Grupin ProCredit ka tejkaluar vlerën prej 1 Miliard Euro ose mbi 20% e total portofolit total të grupit, kurse vetëm në Kosovë ka qenë 98,5 milion Euro, apo 17% e portofolit të përgjithshëm të kredive. Në mënyrë që të vazhdojmë të mbështesim më tutje zhvillimin e qëndrueshëm të klientëve tanë në Kosovë, një prej objektivave tona deri me 2023 është që të nxisim kreditë e gjelbra edhe më tutje dhe të tejkalojmë 20% të portofolit të përgjithshëm. Njëherit, theksojmë se kemi avancuar dhe ngritur kapacitet në vlerësim dhe financim të projekteve në energji të ripërtëritshme që do të ketë fokus të veçantë gjatë vitit 2022.


Sot më tepër se asnjëherë tjetër është e nevojshme që të promovohen investime të qëndrueshme si e vetmja mënyrë e shkëputjes së zhvillimit ekonomik nga përdorimi i burimeve të shtershme. Pra, ne aplikojmë një qasje gjithëpërfshirëse dhe individuale ndaj secilit klient duke financuar projekte të gjelbra të qëndrueshme dhe njëkohësisht vlerësojmë rrezikun që vije nga aktiviteti i klientëve tanë, kështu duke na mundësuar që t'i këshillojmë ata për minimizimin e impaktit të tyre në mjedis dhe shoqëri.

Ky sistem i menaxhimit mjedisor nuk është i mundshëm të jetësohet dhe aplikohet vetëm nga ndonjë person apo departament i vetëm. Andaj ka qenë e nevojshme që të institucionalizohet duke e integruar atë në secilin nivel të strukturës organizative, duke përfshirë secilin staf, nga nivelet e larta menaxheriale, e gjerë te nivelet operationale.

ARSYEJA E PËRZGJEDHJES
SË KOSOVËS PËR KËTË
INVESTIM ËSHTË FAKTI
QË NË KOSOVË RRETH

95%

E ENERGJISË ELEKTRIKE
PRODHOHET NGA
THËNGJILLI QË PËRDORËT
NË DY TERMOCENTRALE
SHUMË TË VJETRA,



KU PËR ÇDO KILOVAT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR LIROJNË RRETH

1 KG CO².

Banka Ekonomike në bashkëpunim me klubin Alpin Prishtina surprizojnë fëmijët e shtrirë në Klinikën Pediatrike



Banka Ekonomike së bashku me klubin Alpin Prishtina ka organizuar aktivitetin e lëshimit me litar nga objekti i Klinikës Pediatrike, me qëllim që gjatë lëshimit anëtarët e grupit Alpin Prishtina si dhe disa punonjës të Bankës Ekonomike të veshur si superheronjë të surprizojnë

fëmijët. Gjatë lëshimit me litar, përveç argëtimit të fëmijëve, janë ndarë edhe disa dhurata modeste për ta.

Banka Ekonomike gjatë këtij aktiviteti po ashtu ka dhuruar donacion për organizatën Care for Kosovo Kids, i cili do të destinohet për blerje të medikamenteve

dhe pajisjeve të nevojshme për Klinikën Pediatrike.

Ky aktivitet nuk është aktiviteti i parë, pasi që edhe në të kaluarën kemi mbështetur Klinikën Pediatrike, por nuk do të jetë as i fundit.

Banka Ekonomike mbjell 540 drunjë në 27 Komuna të Kosovës



Si bankë me kapital 100 përqind vendor, rrjedhimisht mbajmë përgjegjësi sho-

qërore 100 përqind për këtë vend, andaj me rastin e 20 vjetorit të themelimit të

Bankës Ekonomike kemi vendosur që përmes një akti simbolik të mbjelljes së 20 drunjëve në 27 komuna të Kosovës, gjithsejtë 540 drunjë, të sensibilizojmë komunitetin lokal mbi rëndësinë e drunjëve, gjelbërimit, ambientit në përgjithësi dhe duam po ashtu që të vazhdojmë të japim kontributin tonë të mëtejshëm në përmirësimin e mjedisit. Ne shpresojmë që qytetarët e Kosovës të na bashkëngjiten në mbjelljen e sa më shumë drunjëve, kultivimin sa më të madh të gjelbërimit dhe mbrojtjen e ambientit me përgjegjësinë më të lartë të mundshme.



Banka Ekonomike vazhdon mbështetjen për Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë

Edhe këtë vit, sikurse edhe vitin e kaluar, Banka Ekonomike në kuadër të përgjegjësisë sociale ka vazhduar me mbështetjen e kategorive shoqërore të cilat ndërlidhen me fëmijët, konkretisht edukimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre.

Banka Ekonomike i është bashkuar kampanjës të inicuar nga Asociacioni Nacional i Autizmit Kosovë, duke e mbështetur iniciativën përmes blerjes

së punimeve të realizuara me shumë dashuri nga fëmijët me autizëm, përmes së cilës synohet krijimi i kushteve më të mira për ofrimin e shërbimeve për fëmijët, sipas nevojave terapeutike.

Aktivitetet e përgjithshme të ANAK përfshijnë: identifikimin e fëmijëve me autizëm, vlerësimin e shkathtësive të tyre, përgatitjen e planeve të punës, trajnimin e prindërve në ato plane të

punës, ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme direkte ditore të nevojshme, rritje të vetëdijësimit mbi autizmin dhe për shërbimet e nevojshme.

Banka Ekonomike edhe në të ardhmen do të vazhdojë me mbështetjen për shoqërinë tonë, veçanërisht të kategorive të cilat kanë nevojë për përkrahje institucionale dhe të cilat rezultojnë me mirëqenie më të mirë për këto kategori.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sponsor gjeneral i Superligës së Kosovës në futboll



BKT Kosova dhe Federata e Futbollit e Kosovës ka nënshkruar kontratë një vjeçare me 30 gusht 2021, për sponsorizimin e Superligës së Kosovës në futboll, e cila do të quhet BKT Superliga. Për më tepër në mbështetje të digjitalizimit të futbollit në Kosovë,

BKT do të sponsorizojë edhe zhvillimin e platformës digjitale – Sistemin elektronik të shitjes së biletave për BKT Superligën. Kontratën e partneritetit e kanë nënshkruar drejtori ekzekutiv i BKT-së, z. Suat Bakal dhe presidenti i FFK-së, z. Agim Ademi.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sponsor i tenistit Drinor Shamolli



BKT Kosova është e lumtur të mbështesë talentët e rinj të sportit në Kosovë, përkatësisht teniserin e talentuar Drinor Shamolli. 16-vjeçari po vazhdon të tregojë vendosmëri drejt një të ardhmeje të ndritur të tenisit në Kosovë. Mbështetja e sportistëve të rinj

kosovarë është e domosdoshme për zhvillimin e sportit në vendin tonë dhe mbi të gjitha për fuqizimin e sporteve më jopopullore, të cilat mbartin potencial të pasqorë për përfaqësimin e vendit tonë në arena ndërkombëtare.


BKT Kosova sponsor i BKT Premier “VIP Tennis Tournament 2021”



BKT Kosova gjithmonë e gatshme në përkrahje të tenisit në Kosovë. BKT ka qenë sponsor i emrit të turneut të tenisit të quajtur BKT Premier “VIP Tennis Tournament 2021”, organizuar nga Diellza Kolgeci dhe Afërdita Paqarada në bashkëpunim me Federatën e Tenisit të Kosovës.

BKT Premier “VIP Tennis Tournament 2021” është një ngjarje sportive që ka për qëllim promovimin dhe popullarizimin e sportit të tenisit në mesin e rinisë si dhe sensibilizimin në investim të terrreneve të tenisit në Kosovë. Pjesëmarrës të evenimentit ishin personalitete të shquara nga fusha e artit, kulturës, politikës, sporteve të cilët luajtën së bashku me tenistë profesionistë.

Përmbillet me sukses cikli i Akademive të Biznesit organizuar nga BPB – mbi 200 biznese kosovare u trajnuan nga ekspert vendor e të huaj



Ka përfunduar me sukses cikli i parë Akademive të Biznesit që BPB ka organizuar këtë vit në 7 qytetet më të mëdha të Kosovës. Që disa muaj me radhë qindra përfaqësues të bizneseve kosovare janë trajnuar nga ek-

spertë vendor dhe nga ata nga Turqia rreth strategjisë së biznesit, planeve të marketingut dhe menaxhimit të financave, e tema të tjera me rëndësi për menaxhimin, rritjen dhe vazhdimësinë e bizneseve të tyre.

Me Akademinë e mbajtur në Komunën e Prizrenit, është shënuar edhe fundi i ciklit të parë të akademive të Biznesit të organizuara në 7 qytetet më të mëdha të Kosovës nga BPB dhe European Fund For Southeast Europe (EFSE). Mbi 200 biznese kosovare janë trajnuar nga kompania, “GURU Academy” nga Turqia dhe ekspertët më të mirë vendor.

Këto shërbime jofinanciare, kanë ofruar trajnime të ndryshme të cilat do të ju japin mundësi bizneseve që në të ardhmen të zhvillojnë planet e tyre strategjike, planet e marketingut dhe menaxhimin e financave, duke iu lehtësuar menaxhimin, rritjen dhe vazhdueshmërinë e bizneseve të tyre. Qëllimi kryesor i këtyre akademive ishte ngritja e të bërit biznes në një tjetër nivel për të gjithë pjesëmarrësit, gjë që ndikon në zhvillimin e ekonomisë së vendit, pasi që këto përbëjnë shtyllën kyçe të ekonomisë në Kosovë.



Banka e vendit tënd – BPB, miku i Down Syndrome Kosova për 5 vitet e ardhshme

Banka për Biznes do të jetë partner i Down Syndrome Kosova për pesë vitet e ardhshme. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është finalizuar në

fund të muajit tetor, që i kushtohet ndërgjegjësimit për sindromën Down.

Kryeshefi ekzekutiv i Bankës për Biznes, Arton Celina ka vizituar sot shoqatën “Down Syndrome Kosova”, ku së bashku me drejtoreshën ekzekutive të kësaj shoqate, Sebahate Beqiri, kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim 5-vjeçar.

Partneriti 5-vjeçar i BPB-së me shoqatën Down Syndrome Kosova, do të ndikojë dukshëm në rritjen e kujdesit ndaj kategorisë më të dashur të shoqërisë tonë, duke plotësuar nevojat e tyre në disa fusha.

Në saj të këtij bashkëpunimi do të mundësohet që të marrin shërbime në këtë shoqatë fëmijët që deri tani ishin në listë të pritjes.

Gjithashtu, do të ngriten kapacitetet në nivel të vendit për trajnimin e organizuar nga ekspertët e BE-së, “Të ndërtojmë një shkollë gjithëpërfshirëse”.

20 vite kujdes, BPB, miku i fëmijëve.

20 vjet kampionë të sportit, BPB zgjedh minatorët e Trepçës



Banka për Biznes ka nënshkruar sot marrëveshje bashkëpunimi me KB Trepça. Në një takim që ka pasur zëvendës drejtorin e BPB-së, Z. Artan Sadiku me drejtorin e këtij ekipi z.Vullnet Sefaja, palët janë dakorduar që Banka për Biznes të jetë mbështetësi

kryesor në luftën e minatorëve për superligë.

Zëvendëskryeshefi ekzekutiv i Bankës për Biznes, z.Artan Sadiku ka nënshkruar sot marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e KB Trepça, z.Vullnet Sefaja.

Në hotel “Palace” në Mitrovicë, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes pjesëmarrës ishin edhe disa basketbollistë të këtij ekipi.

Në kuadër të kësaj marrëveshje, BPB do të jetë sponsor i ri i minatorëve në luftën e tyre të re për titull të Super Ligës. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, zëvendës drejtorin e BPB-së, z. Artan Sadiku para të pranishmëve ka folur për rëndësinë e këtij bashkëpunimi, duke premtuar se Banka për Biznes do të qëndrojë edhe më tutje afër sportistëve.

Falënderues për Bankën për Biznes është treguar edhe drejtori i ekipit, z. Vullnet Sefaja.

Për Bankën për Biznes bashkëpunimi me ekipet e sportit vendor është me rëndësi të veçantë, andaj edhe në vazhdimësi, është premtuar përkrahje në këtë drejtim.

20 vjet BPB, miku yt!

Banka e vendit tënd – BPB në përvjetorin e 20-të, sjell guidën nga Prizreni



Kosova është e veçantë, andaj BPB këtë vit është guida jote në Prizren, e rreth tij.

Në 20 vjetorin e punës së Bankës për Biznes, të gjithë ata që kanë vendosur ta vizitojnë Kosovën e ta eksplorojnë atë, për të njohur vendet më të mrekullueshme do ta kenë më të lehtë falë BPB-së, që do të sjellë guidën në Prizren, e rreth tij.

Gjithandej, nga malet më të bukura, e qyteti i vjetër me kalldrëm, BPB do të eksplorojë kulturën, për ta sjellë pastaj te miqtë tanë përmes një videoje.

BPB edhe në këtë ditëlindje të 20-të sigurohet që t'i mbetet besnike misionit të

promovimit të bizneseve të vogla e artizanale dhe kulturës lokale.

Guida jonë nuk kishte si të fillonte ndryshe, nëse jo nga kryeqyteti historik i shqiptarëve, Prizreni.

Prizreni vazhdon të mbetet urë lidhëse mes trojeve shqiptare, dhe jo rastësisht është vendi më unik dhe me më së shumti turist në Kosovë.

BPB me rreth 30 persona në Prizren ka vizituar kalanë, artizanatet, shadërvanin e hamamin.

Nga atje, pos që tregohet në pika të shkurta një historik i komunës së dytë me më së shumti banorë në Kosovë, shihen edhe përmes

videos të realizuar pamje të realizuara në një mënyrë që se keni parë më herët.

Pos Prizrenit, qytetarët mund të njihen shkurtimisht edhe me pamje të bukura të Rahovecit, apo ndryshe, vendit të vneshtave.

20 vite sukses të BPB marrin kuptim plotë, atëherë kur kontributi shihet më së miri në fusha që ndihmojnë bizneset e vogla, që preken drejtpërdrejtë nga rritja e turizmit. Në ditëlindjen e 20-të, përveç guides rreth Prizrenit, BPB ka premtuar në vazhdimësi disa surpriza të reja nga sfera e kulturës dhe sportit.



Në vitin 2022 NLB Banka do të mbështet fëmijët për të zhvilluar talentin e tyre në pikturë përmes programit “Për njëri tjetrin” dhe do të mundësoj edukim më cilësor për fëmijët dhe të rinjtë nga komunitetet e marginalizuara.

NLB Banka do të mbështet programin “Për njëri tjetrin” për vitin 2022 nga Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë – ANAK, për të promovuar talentet e fëmijëve me autizëm përmes pikturave. Të gjitha shpenzimet lidhur me materialet e pikturimit do të mbuloohen nga Banka për gjatë gjithë vitit ashtu që fëmijët me gjendje më të rënduar socio-ekonomike të kenë mundësi të zhvillojnë talentin e tyre në pikturë.

Gjithashtu, NLB Banka do të mbështesë fëmijët dhe të rinjtë nga komunitete e marginalizuara duke ju mundësuar një edukim më cilësor në kuadër të kopshteve dhe aktiviteteve ekstrakorrikuale në partneritet me The Ideas Partnership si: klasat e prindërimit, këshillet e fëmijëve, liderët e rinjë, punëtorët e rinj social, klubit I vajzave, klubi I leximit dhe aktivitetet edukative shëndetësore.



NLB Banka mbështetë gratë e prekura nga kanceri i gjirit

Pas përfundimit të muajit Tetor, muajit të ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe fushatës vjetore ndërkombëtare që synon të shpërndajë informacion dhe të edukojë njerëzit për rëndësinë e shëndetit të gjirit, NLB Banka dhuroi epiteza, sutjena dhe paruke për gratë e prekura nga kanceri i gjirit. Donacioni u dorëzua në OJQ “Have Hope”, e themeluar në vitin

2020, që drejtohet nga Arnisa Osmani e cila ka fituar betejën kundër kancerit të gjirit.

Sfida më e madhe është natyrisht vetë sëmundja. Por, në Kosovë merr edhe dimensione tjera, si diagnostifikimi, trajtimi, andaj është shumë me rëndësi që së bashku të kontribuojmë në ndërgjegjësimin dhe luftën kundër kësaj sëmundje. Zbulimi i hershëm shpëton jetë!

Banka ProCredit pastron Batllavën.

Banka ProCredit ndër vite ka ndërmarr iniciativa të cilat ruajn dhe mbrojnë ambientin, një ndër to është edhe pastrimi rreth liqenit të Batllavës. Kjo zonë është një ndër vendet e pakta ku banorët e zonës dhe shumë vizitorë mund të kalojnë kohën e tyre të lirë, prandaj edhe iniciativa e bankës u mirëprit nga banorët e Batllavës. Ndonëse gjatë aktivitetit u mblodhën me qindra thasë mbeturina, zyrtarët nga Banka ProCredit u bëjnë thirrje qytetarëve të e ruajn këtë hapësirë.



Ndikimi i makinave shtesë në mbulimin e programit të Vizitës në Shtëpi



Një nga pengesat më të mëdha për të arritur më shumë gra shtatzëna dhe fëmijë të moshës 0-3 vjeç përmes programit të vizitave në shtëpi është

mungesa e transportit të dedikuar për programin në Qendrat Komunalet të Shëndetit Familjar. Mbështetja me makina rrit mbulimin e fëmijëve që pajisen me paketën e ndërhyrjes për vizita në shtëpi, dhe kjo mundëson ndjeshëm aksesin e fëmijëve që jetojnë në zonat më të largëta. Kështu që në fund të këtij viti Banka Raiffeisen ka dhuruar veturë shtesë për komunën e Vushtrrisë, që është pjesë e komunave që zbatojnë programet e Vizitës në Shtëpi.



Banka Raiffeisen në Kosovë njërën nga përkushtimet e saj të përgjegjës korporative e ka në fushën e edukimit në teknologji.

Për të dytin vit me radhë Banka Raiffeisen përkrah Kosova Makers League. Kosova Makers League Open është gara më e madhe edukative e robotikës dhe e para e këtij lloji në Kosovë, e cila zhvillohet për ciklin e klasave (1-5) dhe (6-9), pra për fëmijët e grupmoshave 6-15 vjeç. Pjesëmarrës në këtë garë mund të bëhen të gjitha shkollat fillore dhe institucionet e tjera edukative duke krijuar një ekip me 5 anëtarë (4 nxënës dhe 1 mentor). Kosova Makers League pajisë secilin anëtar/pjesëmarrës të ekipeve

me nga një robot edukativ - mBot, që ofron hyrje shumë të thjeshtë në botën e robotikës. Nga fëmijët kërkohet të ndërtojnë robotët e tyre dhe gjithashtu t'i programojnë ata. Përmes mbështetjes së Bankës në raundin e parë të garës janë përfshirë 741 nxënës të cilët po aftësohen në fushën e programimit & robotikës dhe 109 mentorë/mësimdhënës të cilët po krijojnë një atmosferë shumë më ndryshe në shkollat e tyre duke sjellë një çasje të re edukative të fushave STEM në sistemin e rregullt edukativ në Kosovë.



Mbushës për vetura elektrike për një ambient më të pastër

Minimizimi i ndikimit negativ në mjedis dhe promovimi i një mënyrë të qëndrueshme të të bërit biznes, është pjesë përbërëse e strategjisë së Bankës ProCredit - jo vetëm në lidhje me aktivitetin e huadhënies apo ofrimin e shërbimeve financiare për klientë, por edhe në veprimet ditore. Së fundi, Banka ProCredit ka dhuruar 19 mbushës të veturave elektrike në kuadër të projektit për promovimin e praktikave miqësore në tërë territorin e Kosovës. Këta mbushës do të jenë në dispozicion të qytetarëve të komunave si Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Podujevë, Pejë, Gjakovë dhe Gjiilan për të vazhduar edhe me komuna tjera në muajt në vijim.



TEB organizoi diskutimin me temën “Qasja në Financa për Gratë Ndërmarrëse”

Përfaqësues shtetëror, të institucioneve ndërkombëtare e vendore bashkë me përfaqësues të Bankës TEB kanë diskutuar për financimin e aktiviteteve afariste të

Grave ndërmarrëse duke shënuar Javën Ndërkombëtare të Ndërmarrësisë (Global Entrepreneurship Week). Panelistët e diskutimit të organizuar nga Banka TEB

u pajtuan se duhet të krijohet një strategji e përbashkët me të gjithë akterët, në mënyrë që ndikimi i secilit program apo institucion të shumëfishohet.

Banka TEB në përkrahje edhe të Komitetit Paralimpik të Kosovës



Banka TEB duke qenë pjesë e Bankës me shtrirje globale, BNP Paribas ndër katër shtyllat kryesore të funksionimit

ka edhe përgjegjësinë korporative sociale ndaj komunitetit. Në këtë vazhde pas marrëveshjeve me Federatën e futbollit

(FFK), të basketbollit (FBK) dhe së fundi Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) ishte i pritur një bashkëpunim edhe me Komitetin paralimpik të Kosovës (KPK). Sipas marrëveshjes së arritur, Banka TEB do të jetë përkrahëse e aktiviteteve të Komitetit paralimpik të Kosovës për katër vitet e ardhshme.

Marrëveshja është nënshkruar nga zëvendës drejtori menaxhues i Bankës TEB, Serhan Ozarslan dhe presidentes së KPK-së, Njomëza Emini.

Banka TEB mbetet e përkushtuar për të përkrahur komunitetin dhe konsiderojmë se sporti është njëra ndër pjesët më të ndritura të shoqërisë kosovare, andaj edhe kemi konsideruar me vendosmëri përkrahjen e rinisë nëpërmjet aktiviteteve sportive të ekipeve dhe federatave kombëtare sportive.

TEB Bankë për një botë në lëvizje!


PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“The Kosovo Banker” është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Revista botohet dy herë në vit dhe ka për qëllim të informojë publikun lidhur me industrinë bankare në Republikën e Kosovës. Për më tepër informata, drejtohuni tek web faqja e Shoqatës së Bankave të Kosovës.



PUBLIKIME TË TJERA NGA SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS





QENDRA E TRAJNIMEVE NË SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS

Shoqata e Bankave të Kosovës themeloi Qendrën e Trajnimeve Bankare në vitin 2005 për të promovuar shkëmbimin e njohurive, edukimin e vazhdueshëm dhe për të mbështetur gjeneratat e reja të bankierëve në Kosovë!

Me mbështetjen e bankave anëtare dhe organizatave partnere, ne vazhdojmë të ofrojmë trajnime të nivelit të lartë për qindra profesionistë bankarë çdo vit, duke angazhuar ekspertë të njohur ndërkombëtarë. Trajnimet e ofruara kanë për qëllim gjithashtu përafrimin e sektorit financiar në Kosovë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Përmes këtyre trajnimeve shumë të specializuara që kemi realizuar ndër vite, ne kemi kontribuar në rritjen e kapaciteteve tek të rinjtë në Kosovë, të cilët tani nuk punojnë vetëm për bankat, por janë të punësuar në të gjithë sektorët e ekonomisë në vend.

PARTNERËT:



Qendra për trajnime bankare në kuadër të programit të saj të trajnimeve ofron edhe certifikime të njohura ndërkombëtare, uebinare dhe trajnime përmes kanaleve elektronike në fushën e industrisë bankare.



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

#KosovoBankingAssociation

#KosovoBankingAssociation

Shoqata e Bankave të Kosovës është anëtare e Rrjetit Evropian për Trajnime Bankare (EBTN).



<https://www.bankassoc-kos.com/>